



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 43 regjistër (JR)  
Datë 30.09.2020

Nr. 35 i vendimit  
Datë 23.11.2021

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Relator</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 23.11.2021, në orën 12:00, ditën e martë, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonći Petković, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 43/2020, datë 30.09.2020, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Darjel Sina.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 273, datë 10.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 273, datë 10.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesen ligjore të

saj, znj. Irena Reso, që kërkuan përfundimisht lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtares, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Më parë, në funksion dhe për zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), sipas të cilave ka rezultuar:

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport<sup>1</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
- (ii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;
- (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- (v) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit (në vijim “KDZh”) nr. {\*\*\*}, datë 11.09.2019), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja.

2.3 KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv

---

<sup>1</sup> Raporti i ILDKPKI-së nr. {\*\*\*} prot., datë 30.01.2018.

dhe rastësor, dhe ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 27.05.2019, për subjektin e rivlerësimit.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e rivlerësimit (të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale) dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 273, datë 10.07.2020.

## **II. Në lidhje me vendimin e Komisionit**

4. Komisioni, me vendimin nr. 273, datë 10.07.2020, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
5. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 59, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

*5.1. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.*

**5.2.** Komisioni, me vendimin nr. 273, datë 10.07.2020, përfundimisht ka vendosur:

*- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, me funksion gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.*

*Në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë vendimet e mëposhtme pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, si më poshtë vijon:*

- vendim nr. {\*\*\*}, datë 07.12.2016, i Gjykatës së Lartë;*
- vendim nr. {\*\*\*}, datë 06.07.2016, i Gjykatës së Lartë;*
- vendim nr. {\*\*\*}, datë 29.09.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit;*
- vendim nr. {\*\*\*}, datë 18.02.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit.*

## **III. Në lidhje me shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik**

6. Bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “c” e Aneksit të Kushtetutës, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), më datë 30.07.2020, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë me nr. {\*\*\*} prot., “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 273, datë 10.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja. Objekti i këtij rekomandimi lidhet me rezultatet e dala nga hetimi administrativ për (i) kriterin e pasurisë; (ii) dhe kriterin e aftësive profesionale. Si konkluzion, ONM-ja rekomandon që procesi i rivlerësimit për znj. Gazidedja të rishikohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe, në përfundim, vendimi i Komisionit të ndryshohet.

7. Komisioneri Publik Darjel Sina (në vijim “Komisioneri Publik”) ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 273, datë 10.07.2020, për subjektin e rivlerësimit, duke konsideruar se ndryshe nga sa disponon Komisioni për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

*i. Shkaqe ankimi që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë*

**7.1 Lidhur me pasurinë godinë banimi 3 kate**, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, Komisioneri Publik pretendoi se ka mospërputhje dhe deklarime kontradiktore midis deklaratave periodike dhe asaj *vetting* me vetëdeklarimet e vitit 2006 që gjenden në dosjen e legalizimit, për sa i përket kohës së ndërtimit të godinës dhe numrit të kateve të saj, nga ku rezulton se në këto vetëdeklarime koha e ndërtimit është viti 1998 dhe numri i kateve është 3, ndërsa në deklaratën *vetting* rezulton që ndërtimi ka filluar në vitin 1997. Gjithashtu ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues mbështetës për investimet dhe shpenzimet e kryera për ndërtimin e godinës, si dhe për shpenzimet e mobilimit të saj. Sipas Komisionerit Publik, ka deklarime kontradiktore edhe për burimin e deklaruar të krijimit të kësaj pasurie, si dhe për pjesët takuese të saj. Komisioneri Publik vlerësoi se duke llogaritur koston e investimit duke i zbritur TVSh + Fond Rezervë + Fitim, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk do të mbulonin me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie, respektivisht për periudhën 1997-2003 për vlerën 138.467 lekë, në vitin 2004 për vlerën 2.443.656 lekë, në vitin 2006 për vlerën 2.566.001 lekë.

**7.2 Lidhur me pasurinë “truall me sipërfaqe 437,6 m<sup>2</sup>”**, parcelë ndërtimore e godinës së banimit me 3 kate, Komisioneri Publik pretendoi se në analizën financiare të vitit 2010, duhet të përfshihen vetëm të ardhurat e prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpenzimet e jetesës familjare, duke përfshirë edhe prindërit.

**7.3 Lidhur me pasurinë “njësi me sip. 25,7 m<sup>2</sup>”**, me adresë rruga “{\*\*\*}” Tiranë, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe rrjedhimisht nuk mbulon me burime të ligjshme shumën prej 1.000.000 lekësh, si pjesë e krijimit të depozitës së përdorur për blerjen e kësaj pasurie. Gjithashtu Komisioneri Publik pretendon se mbetet e paprovuar mundësia financiare e personit tjetër të lidhur, për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të.

**7.4 Lidhur me pasurinë “autoveturë Mercedes Benz ML”**, me targë {\*\*\*}, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që në kuadër të ligjit 9049/2003, të deklarojë ndryshimet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë dhe likuiditetet *cash*, në fund të çdo viti kalendarik. Në përfundim, për këtë pasuri, në mungesë të përmbushjes së detyrimit ligjor për deklarimin e shtesave apo pakësimeve të likuiditeteve *cash*, subjekti i rivlerësimit nuk provoi gjendjen *cash* në fund të vitit 2008, apo në janar të vitit 2009, si rrjedhojë nuk provoi mbulimin me të ardhura nga burime të ligjshme të shumës 5.000 euro ose 615.000 lekë në janar të vitit 2009.

*7.5 Lidhur me pasurinë “Automjet tip Peugeot”, me targë {\*\*\*}, në emër të personit të lidhur D. G., Komisioneri Publik pretendoi se analiza financiare përfundimtare e Komisionit, paraqitur në vendim, i përket periudhës janar 2014 - dhjetor 2014, e cila në fakt duhet t’i referohej së njëjtës periudhë për të cilën subjektit iu kalua barra e provës, për të provuar të kundërtën, pra të periudhës 01.01.2014 – 25.08.2014. Si rrjedhojë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, duhet të analizohen për këtë periudhë duke mos përfshirë të ardhurat nga qiradhënia, detyrimet tatimore të të cilave janë paguar gjatë procesit administrativ, si dhe në zërin e shpenzimeve duhet të përfshihen shpenzime shkollimi, në shumën 1.620 euro, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën e Interesave Privatë të Pasurisë (në vijim “DIPP”) të vitit 2014 dhe të kryera në periudhën janar – qershor 2014.*

*7.6 Lidhur me “kursimet në cash në shumën 1.400.000 lekë”, deklaruar në DIPP-në e vitit 2016, Komisioneri Publik pretendoi se përfshirja e të ardhurave nga qiraja për shumën prej 168.000 lekësh për vitin 2016, nuk përputhet me dokumentacionin e depozituar në dosje të subjektit të rivlerësimit, vërtetimin nga Drejtoria Rajonale Tatimore mbi të ardhurat e realizuara nga qiradhënia, për të cilat janë shlyer dhe detyrimet tatimore në kohën e realizimit të këtyre të ardhurave. Rezulton se për të ardhurën e deklaruar në vlerën 168.000 lekë, subjekti ka shlyer detyrimet tatimore vetëm pas kalimit të barrës së provës nga ana e Komisionit, ndaj këto të ardhura, në vlerësimin e Komisionerit Publik, nuk duhet të përfshihen në burimet e ligjshme të krijimit të pasurive.*

*7.7 Lidhur me mosdeklarimin e përdorimit të autoveturës me targa {\*\*\*}, Komisioneri Publik pretendoi se qëndrimi i Komisionit në drejtim të elementeve subjektive të dashjes e qëllimit, është në kundërshtim me qëndrimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Polica e sigurimit rezulton e prerë në tri periudha, nga ku ajo e fundit është 1-vjeçare, ndryshe nga sa referon Komisioni, si dhe nuk është deklaruar trajtimi preferencial në DIPP-në e vitit 2016 dhe DIPP-në e vitit 2017.*

*ii. Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

**8.** *Lidhur me denoncimin anonim, i protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.01.2020, në të cilin pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje të shoqërisë "{\*\*\*}" ShA duke qenë njëkohësisht dhe aksionere e kësaj shoqërie, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara në pikën 1 të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, pasi në momentin e shqyrtimit të këtyre rasteve ka pasur interes mbi këtë proces, pasi dispononte aksione në shoqërinë "{\*\*\*}" ShA, palë në këtë proces gjyqësor.*

**8.1** *Në vijim të denoncimit anonim të protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.01.2020, në të cilin pretendohet se në dy çështje subjekti i rivlerësimit kishte gjykuar të njëjtën çështje si në shkallë të parë ashtu edhe në apel, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me detyrimin kushtetues për gjykimin e paanshëm nga gjykatat, duke qenë anëtare e trupës gjyqësore në dy shkallë të ndryshme gjykimi, për të njëjtin objekt dhe palë, duke mos respektuar në këtë mënyrë parimin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor, të parashikuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.*

**8.2** Lidhur me denoncimin nr. {\*\*\*}, datë 24.04.2019, të denoncuesit Q. V., i cili ankohet se trupi gjykues ku në përbërje të të cilit ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit, është mbështetur në një vendim gjykate, i cili rezulton të jetë prishur nga gjykata më e lartë, Komisioneri Publik pretendoi se shkelja e konstatuar është e karakterit procedural dhe duhet marrë parasysh në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**8.3** Lidhur me denoncimin nr. {\*\*\*}, datë 08.04.2019, të denoncuesit P. P., i cili ankohet ndaj trupës gjykuese të Gjykatës Administrative të Apelit duke pretenduar se nga ana e saj ka shkelje procedurale në dhënien e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 14.02.2018, ku subjekti i rivlerësimit rezulton se ka qenë anëtar i trupit gjykues, Komisioneri Publik pretendoi se shkelja e konstatuar është e karakterit procedural dhe duhet marrë parasysh në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**8.4** Komisioneri Publik ka renditur ndër shkaqet për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, edhe të dhënat nga raporti i vlerësimit profesional të hartuar nga KLGj-ja, ku kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, si dhe nga inspektimi i Ministrisë së Drejtësisë në Gjykatën Administrative të Apelit, ku subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me vonesa kohore në gjykim. Bazuar në gjetjet dhe mangësitë e konstatuara nga KLGj-ja, si dhe gjetjet e inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë, të konfirmuara këto edhe nga hetimi administrativ i Komisionit, në pamundësi të vlerësimit të dosjeve fizike objekt vlerësimi, Komisioneri Publik është ndalur në faktin e konstatuar të tejkalimit të afateve të gjykimit, si model i vërejtur në më shumë se një herë në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi ky fakt së bashku dhe me mangësitë e tjera, në këndvështrim të nenit E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, përbën cenim të së drejtës së qytetarëve për një gjykim brenda afateve të arsyeshme.

**8.5** Komisioneri Publik kërkoi që shkaqet e këtij ankimi t'i marrë në shqyrtim Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 273, datë 10.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja.*

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

##### *A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit*

##### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm i Apelit (në vijim "Kolegji") ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr

në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016. Meqenëse çështja e subjektit të rivlerësimit ka rekomandim nga ONM-ja, mbi bazën e ndryshimeve të rregullores për veprimtarinë e Kolegjit, sipas nenit 20, pika 1, paragrafi i dytë të kësaj rregulloreje, sipas së cilës çështja që i përket ankimit të Komisionerit Publik, i cili është bërë mbi bazën e një rekomandimi të vëzhguesve ndërkombëtarë, shqyrtohet me përparësi, pavarësisht datës së regjistrimit në Kolegj, çështja e subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, u shqyrtua me përparësi.

*ii. Legjitimimi i ankuesit*

10. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

11. Në përputhje me nenin 65<sup>2</sup>, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 273, datë 10.07.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.

*B. Mbi aspektet procedurale lidhur me provat dhe kërkesat e Komisionerit Publik, si dhe me parashtrimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor, Kolegji konstaton si më poshtë.*

12. Në seancën gjyqësore publike të datës 28.10.2021, Komisioneri Publik, në parashtrimet e depozituara në Kolegj, pasi u shpreh se u qëndron shkaqeve të ankimit, mbështetur në parashikimet e nenit F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi që shkaqet e parashtruara në këtë ankim, të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit.
13. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj në seancën e datës 28.10.2021, në përfundim, kërkoi mospranimin e ankimit të bërë nga Komisioneri Publik dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 273, datë 10.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
14. Kolegji mori në shqyrtim gjyqësor faktet e pretenduara në ankim, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të mbrohet dhe të japë shpjegime në lidhje me to. Kolegji vlerësoi të gjitha shkaqet

---

<sup>2</sup> *Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".*

e ankimit në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë dhe vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegj nga Komisioni dhe parashtrimet e depozituara nga palët gjatë seancave publike, si dhe bazuar në legjislationin e zbatueshëm, trupi gjyqësor i Kolegjit arrin në konkluzionet e mëposhtme.

*C. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit*

15. Lidhur me pasurinë godinë banimi me 3 kate, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, Komisioneri Publik pretendoi se ka mospërputhje dhe deklarime kontradiktore midis deklaratave periodike dhe asaj *vetting* me vetëdeklarimet e vitit 2006 që gjenden në dosjen e legalizimit, për sa i përket kohës së ndërtimit të godinës dhe numrit të kateve të saj, nga ku rezulton se në këto vetëdeklarime koha e ndërtimit është viti 1998 dhe numri i kateve është 3, ndërsa në deklaratën *vetting* rezulton që ndërtimi ka filluar në vitin 1997. Gjithashtu ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues mbështetës për investimet dhe shpenzimet e kryera për ndërtimin e godinës, si dhe për shpenzimet e mobilimit të saj. Sipas Komisionerit Publik ka deklarime kontradiktore edhe për burimin e deklaruar të krijimit të kësaj pasurie, si dhe me pjesët takuese të saj. Komisioneri Publik vlerësoi se duke llogaritur koston e investimit, duke i zbritur TVSh + Fond Rezervë + Fitim, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk do të mbulonin me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie, respektivisht për periudhën 1997-2003 për vlerën 138.467 lekë, në vitin 2004 për vlerën 2.443.656 lekë, në vitin 2006 për vlerën 2.566.001 lekë.

15.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe ka dalë në përfundimin se investimi nga viti 1997-2006 është në vlerën 7.034.541 lekë dhe nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme investimin e kryer në godinën e banimit në vlerën - 596.181 lekë. [...] Duke vënë në bilanci vlerën e rezultatit negativ në vitin 2005 në raport me provat e reja, vlerësohet se balanca negative e këtij viti nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore duke qenë se nuk përmbushet kriteri i parashikuar në pikën 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit 84/2016. [...] Për sa i përket pasaktësive të konstatuara për deklarin e vlerës, sipërfaqes dhe burimit të të ardhurave për këtë investim, Komisioni ka vlerësuar se: [...] këto pasaktësi në deklaratat periodike vjetore nuk ndikojnë në analizën financiare si dhe nuk kanë pasur për qëllim fshehjen apo paraqitjen e pasaktë të pronës.*

15.2 Në deklaratën “*vetting*”, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Shtëpi banimi 3 kate, me sip. kati përdhe 143 m<sup>2</sup> dhe sip. verande 20,5 m<sup>2</sup>, sip. kati parë 150,5 m<sup>2</sup> dhe sip. kati dytë 192,3 m<sup>2</sup> model papafingo, dhe sip. trualli 437,6 m<sup>2</sup>, me numër pasurie {\*\*\*}, zona kadastrale {\*\*\*}, Tiranë, rruga: “{\*\*\*}” [...] Pasuria është në bashkëpronësi me bashkëshortin, vjehrrin dhe vjehrrën [...] Burimi i të ardhurave: nga puna e deklarueses, bashkëshortit në shtet dhe privat, shitja e banesës në qytetin e Peshkopisë, të ardhurat e vjehrrit dhe vjehrrës, kredi të ProCredit Bank, dhënia me qira e pjesës së banesës, shitje makine. Vlera e deklaruar: 6.000.000 lekë, vlera e truallit është paguar 2.040.000 lekë me bono privatizimi dhe me lekë në vlerën 1.989.510 lekë.*



*Në deklaratën fillestare të pasurisë*, subjekti i rivlerësimit deklaron: *Banesë private një kat ndërtimi me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup>, Tiranë; vlera e deklaruar 2.000.000 lekë, burimi nga shitja e një banese të familjes së bashkëshortit në qytetin e Peshkopisë. Pjesa takuese 50%.*

*Në DIPP-në e vitit 2004*, subjekti i rivlerësimit deklaron: *Shtesë kati mbi shtëpinë ekzistuese për të cilën kam marrë kredi + të ardhura. Burimi: vlera e kredisë 11.000 euro. Pjesa takuese: 1/3 e saj. Data e krijimit të pasurisë: viti 2004.*

*Në DIPP-në e vitit 2006*, subjekti deklaron: *Shtesë kati papafingo, e palegalizuar, gjithë shtëpia në proces legalizimi. Pjesa takuese 50%. Subjekti i rivlerësimit në këtë deklaratë nuk ka deklaruar sipërfaqen dhe vlerën/shpenzimet e shtesës së katit.*

**15.3** Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se më datë 07.02.2011, me lejen e legalizimit nr. {\*\*\*}, është legalizuar objekti godinë banimi me 3 kate, në emër të z. A. G. dhe D. G., sipërfaqja e parcelës ndërtimore 437,6 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja e ndërtimit 143 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja totale e ndërtimit për banim e tre kateve është 536,4 m<sup>2</sup>. Kjo pasuri është deklaruar në formularin e legalizimit, datë 15.11.2006, (shtojca A) si ndërtim i vitit 1998, ku të banueshme janë kati përdhe dhe kati i parë, ndërsa kati i dytë është në gjendje karabina, për të cilin nuk disponojnë dokumentacion për koston e ndërtimit, nënshtruar procedurave të legalizimit.

**15.4** Me kontratën nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 06.12.2010, është bërë kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore me sipërfaqe 437,6 m<sup>2</sup> të bashkëshortit i subjektit të rivlerësimit dhe babai i tij. Në këtë kontratë janë përcaktuar vlerat e mëposhtme.

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 75.989 lekë, e cila rezulton e paguar në datë 01.11.2010, me mandat arkëtimi të Credins Bank nga D. G.
- Parcela ndërtimore në vlerën 1.989.510 lekë, e cila rezulton e paguar në datë 01.11.2010, me mandat arkëtimi të Credins Bank nga D. dhe A. G.
- Parcela ndërtimore, letra me vlerë në shumën 2.140.000 lekë (280.000 lekë + 1.860.000 lekë), e cila rezulton e paguar më datë 01.11.2010 dhe 03.11.2010, me mandat arkëtimi të Credins Bank nga D. dhe A. G.
- Penalitete dhe deklarim me vonesë në vlerën 8.752 lekë, e cila rezulton e paguar më datë 01.11.2010, me mandat arkëtimi të Credins Bank nga D. G.

**15.5** Nga ana e ZVRP-së Tiranë, konfirmohet fakti se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe babai i tij kanë në bashkëpronësi me ½ pjesë takuese prej vitit 2011, pasurinë nr. {\*\*\*} ZK {\*\*\*}, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, me sipërfaqe trualli 437,6 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtesë 143 m<sup>2</sup>. Në kartelën e pasurisë, ndërtesa specifikohet si godinë banimi me 3 kate, ku sipërfaqja e katit përdhe është 143 m<sup>2</sup> dhe verandë 20,6 m<sup>2</sup>, sipërfaqja e katit të parë është 180,5 m<sup>2</sup>, sipërfaqja e katit të dytë është 192,3 m<sup>2</sup>.

**15.6** Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, për ndërtimin e godinës së banimit 3-katëshe bazuar në kostot e ndërtimit sipas udhëzimeve të EKB-së, si dhe deklarimet e subjektit të rivlerësimit në DIPP për kohën e ndërtimit dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ. Në

përfundim të këtij hetimi, Komisionit i ka rezultuar se investimi total për ndërtimin e godinës, nga viti 1997–2006, është në vlerën 10.779.636 lekë, ndaj subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime nga të ardhura të ligjshme këtë investim, shkak për të cilin Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

**15.7** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e datës 10.12.2019 ndaj rezultateve të hetimit, ka shpjeguar se: *[...] edhe nëse nuk do të merret i mirëqenë fakti i qenies në një ekonomi të përbashkët, i pakontestueshëm është fakti se shtëpia është në bashkëpronësi të A. G. dhe D. G., është ndërtuar nga të gjithë në bashkë, si e tillë do të duhet të llogaritet mundësia e kontributit të dy familjeve, dhe jo të më ngarkohet e gjithë vlera e ndërtimit të shtëpisë vetëm mua, subjektit të rivlerësimit.*

Në parashtrimet e paraqitura në seancë publike në Kolegj, subjekti i rivlerësimit argumentoi: *[...] Pavarësisht se kemi jetuar në një ekonomi të përbashkët familjare, prindërit e bashkëshortit nuk kanë qenë subjekt deklarues. Në të gjitha deklaratat e pasurisë, nga vitit 2003-2015, unë nuk kam deklaruar gjendje cash. Për herë të parë, gjendjen cash në banesë e kam pasqyruar në DPP-2016 [...].* Lidhur me këtë argument të subjektit të rivlerësimit, Kolegji konsideroi se pjesët e barabarta të një bashkëpronësie nuk tregojnë domosdoshmërisht për kontribut të barabartë në kushtet e një ekonomie familjare të përbashkët, dhe në mungesë të provueshmërisë së këtij elementi, të ardhurat e njësisë kanë shkuar së bashku për të gjithë ndërtimin, pa përcaktuar pjesë në kontribute, duke mos e pjesëtuar kështu koston e ndërtimit sipas pjesëve në bashkëpronësi të këtij ndërtimi. Si rrjedhojë, nga gjithë dokumentacioni që u administrua në Komision, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të prindërve të bashkëshortit të tij, potencuar edhe nga subjekti i rivlerësimit gjatë seancave publike në Kolegj se të ardhurat e familjes menaxhoheshin nga babai i bashkëshortit, u konsideruan si kontribut i përbashkët për ndërtimin e godinës, por pa i ndarë këto të ardhura në pjesë takuese sipas përkatësisë së regjistrimit të kësaj pasurie të paluajtshme.

Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit që ndodhet në kushte të njëjta me situatën faktike të trajtuar në vendimin e Kolegjit nr. 14/2021 (JR), datë 15.06.2021, tek i cili, për verifikimin e ligjshmërisë së burimeve për kryerjen e investimit të përbashkët, trupi gjykues i Kolegjit i ka atribuar subjektit të rivlerësimit pasojën e të mosprovuarit, për secilin prej bashkëpronarëve, të ligjshmërisë së burimit për kryerjen e investimit, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, nuk gjendet në të njëjtat rrethana faktike, pasi kjo e fundit ndodhet në ekonomi të përbashkët familjare me personat me të cilët gëzon bashkëpronësinë e godinës së ndërtuar.

**15.8** Kolegji vëren se Komisioni në vendimin e tij, në lidhje me kohën e ndërtimit të godinës, u është referuar deklarimeve të subjektit, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ. Konkretisht, në rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka vlerësuar:

(i) Kati përdhe prej 143 m<sup>2</sup>, viti i fillimit të ndërtimit është konsideruar viti 1997 dhe viti i përfundimit viti 2003. Ndërkohë që nga Komisioni janë administruar deklaratimet e subjektit, në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie të vitit 2003, si dhe nga të dhënat e OSHEE-së ku rezulton se kontrata është lidhur para vitit 2003, dhe konkretisht me shkresën nr.

{\*\*\*} prot., datë 18.07.2019, drejtuar Komisionit, ku OSHEE-ja konfirmon instalimin e matësit të energjisë elektrike më datë 14.09.1999.

(ii) Kati i parë prej 180,5 m<sup>2</sup>, viti i ndërtimit është konsideruar viti 2004, pasi nga deklaratimet e subjektit, por dhe nga dokumentacioni i administruar, rezulton se subjekti i rivlerësimit është debitor solidar me bashkëshortin e tij te një kredi e marrë pranë Procredit Bank, në vlerën 11.000 euro për konstruksionin e godinës.

(iii) Kati i dytë (papafingo) 192,3 m<sup>2</sup>, viti i ndërtimit është konsideruar vitit 2006, duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit, kohën e ndërtimit të katit të parë, si dhe aplikimin pranë ALUZINI-t. Komisioni, bazuar në këtë vlerësim të tij për kohën e ndërtimit të godinës, si dhe në pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka rilogaritur kostot e ndërtimit dhe ka konkluduar se investimi në total për ndërtimin e banesës trekatëshe, duke filluar nga viti 1997 – 2006, është në vlerën 7.034.541 lekë dhe, nga analiza financiare, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme investimet e kryera për godinën e banimit në vitin 2005, në shumën -596.181 lekë, për të cilën Komisioni ka vlerësuar se: [...] *duke vënë në balancë vlerën e rezultatit negativ në vitin 2005, në raport me provat e reja, vlerësohet se balanca negative e këtij viti nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.* Ndërsa për pasaktësitë e konstatuara për deklarinimin e vlerës, sipërfaqes dhe burimit të të ardhurave për këtë investim, Komisioni ka vlerësuar se: [...] *këto pasaktësi në deklaratat periodike vjetore nuk ndikojnë në analizën financiare, si dhe nuk kanë pasur për qëllim fshehjen apo paraqitjen e pasaktë të pronës.*

**15.9** Kolegji, pas verifikimit të dokumentacionit të administruar në dosje, konstatoi se ka mospërputhje dhe deklarime kontradiktore midis deklarinimit të parë të vitit 2003, DIPP-së së vitit 2004, DIPP-së së vitit 2006 dhe deklaratës *vetting* krahasuar këto me vetëdeklarimet e datave 13.11.2006 dhe 15.11.2006 që gjenden në dosjen e legalizimit, për sa i përket kohës së ndërtimit të godinës dhe numrit të kateve të saj, nga ku rezulton se në vetëdeklarimet, koha e ndërtimit është viti 1998 dhe numri i kateve është 3, ndërsa në deklaratën *vetting* rezulton që ndërtimi ka filluar në vitin 1997, në deklarinimin e parë të vitit 2003 në faqen nr.4, në rubrikën pasuri të paluatshme dhe të drejta reale mbi to deklarohet “banesë private një kat ndërtim sipërfaqe 100m<sup>2</sup>, Në DIPP-në e vitit 2004 shtesë kati, në DIPP-në e vitit 2006 shtesë kati (papafingo). Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi gjithashtu mungesë dokumentacioni ligjor justifikues mbështetës për investimet dhe shpenzimet e kryera për ndërtimin e godinës, të tilla si situacione punimesh apo fatura pagesash, mungesë dokumentacioni ligjor justifikues mbështetës për shpenzimet e mobilimit të saj, si dhe deklarime kontradiktore për burimin e deklaruar të krijimit të saj, ku në deklaratën *vetting* deklarohen gjashtë burime, ndërsa në deklaratat periodike vjetore identifikohen tri burime. Gjithashtu, edhe në lidhje me pjesët takuese, ka një konfuzion ku janë deklaruar me 50% (deklarata e parë), vazhdojnë me 1/3 pjesë (DIPP - 2004) dhe përfundojnë me bashkëpronësi në pjesë ideale (deklarata *vetting*).

**15.10** Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e dorëzuara në Kolegji në seancën gjyqësore publike, lidhur me pasaktësitë e parashtruara në paragrafin më sipër, argumentoi se: *sikundër e kam*

*shprehur në deklaratën vetting, vlera e ndërtimit të kësaj banese është 6.000.000 lekë, mosdeklarimi i plotë i vlerës së shtëpisë në deklaratat periodike të deklarimit të pasurisë, është një pakujdesi/pasaktësi, e cila ka si shkak edhe faktin që ndërtimi ishte informal. Duke qenë i tillë, ai mund të mos legalizohej asnjëherë, ai nuk ishte send në qarkullimin civil në momentin e deklarimit.*

**15.11** Komisioneri Publik pretendoi në ankim se ekzistojnë dy mundësi analize të burimit të ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e godinës, që lidhen me periudhën kohore të ndërtimit të godinës dhe numrit të kateve. E para do të bazohej në vetëdeklarimet për efekt të procesit të legalizimit, që referojnë si kohë të ndërtimit vitin 1998 dhe godinë tri kate, e dyta do të bazohej në deklaratat periodike, ku është deklaruar ndërtimi i secilit kat dhe vlera përkatëse, pra në deklarimin e parë që mbulon periudhën kohore deri më datë 31.12.2003, për sipërfaqen 143 m<sup>2</sup> + 20 m<sup>2</sup> verandë-kati përdhe për periudhën 01.01.1997 - 31.12.2003, me vlerë të deklaruar 2.000.000 lekë, në DIPP-2004 për periudhën 01.01.2004 - 31.12.2004, për sipërfaqen 180,5 m<sup>2</sup> – kati i parë, me vlerë të deklaruar 11.000 euro dhe në DIPP-2006, për periudhën 01.01.2006 - 31.12.2006, për sipërfaqen 192,3 m<sup>2</sup> për të cilën nuk deklarohet vlera.

**15.11.1** Kolegji vëren se, nga shqyrtimi i akteve të dosjes së administruar në Komision për subjektin e rivlerësimit, në praktikën e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale (në vijim “ALUIZNI”) gjendet formulari i vetëdeklarimit, si pjesë e procedurave të nevojshme për legalizimin e banesës. Në këtë formular të plotësuar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe vjehri i tij është deklaruar si vit ndërtimi i banesës, viti 1998. Duhet theksuar se ky formular legalizimi është plotësuar në datën 15.11.2006. Gjithashtu, në këtë formular tip, në rubrikën “numri i kateve mbi tokë”, është shënuar 3 kate.

**15.11.2** Në dosjen e administruar në Kolegji, gjendet dokumenti “informacion për abonentin”, i lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Energjisë Elektrike (në vijim “OSHEE”) ku ndër detajet e abonentit, rezulton edhe data e hapjes së kontratës për banesën e subjektit të rivlerësimit, e cila mban si periudhë të lidhjes së saj 17.09.1999, duke ngritur dyshimin në një nivel të arsyeshëm për trupin gjykues se viti 1999 mund të jetë periudha në të cilën janë përfunduar punimet e katit përdhe. Në Kolegji u krye analiza financiare për ndërtimin e katit përdhe të banesës gjatë periudhës 1997, sipas deklarimit të subjektit në deklarimin e parë të vitit 2003, deri në vitin 1999 sipas kontratës së OSHEE-së, ku sipas kësaj përllogaritje, për ndërtimin e katit përdhe për periudhën 1997-1999, rezultoi me diferencë negative në vlerën 3.721.138 lekë.

**15.11.3** Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të provuar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij, në këtë rast të lidhura ngushtë me vlerën që do të pranohet se ka pasuria “godinë 3-katëshe”. Ky detyrim buron nga parashikimi i nenit Ç, pika 5 dhe nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si edhe nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, por pavarësisht kësaj, subjekti nuk ka paraqitur as bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* dhe as përgjatë hetimit administrativ, dokumentacion justifikues i cili do të provonte dhe vërtetonte pagesat e kryera për ndërtimin e saj, çdo akt shkresor që do të dokumentonte shpenzimet e kryera prej saj apo prej familjarëve për ndërtimin e kësaj banese. I vetmi akt i paraqitur prej subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim, është akti i ekspertimit teknik, i hartuar prej dy ekspertëve të

kontraktuar prej tij, për nevoja të procesit të rivlerësimit. Kolegji nuk e ka konsideruar me vlerë provuese këtë akt ekspertimi, përtej faktit që ai është hartuar nga ekspertët, siç rezulton në përgjigje të kërkesave dhe sugjerimeve apo fakteve të servirura prej subjektit dhe të pacertifikuara nga ndonjë autoritet publik, po në funksion të procesit të rivlerësimit. Kolegji kreu përllogaritjen duke aplikuar tarifën e përcaktuara nga aktet nënligjore për vitet e ndërtimit, të cilat zbatohen nga EKB-ja për koston sipas sipërfaqes së ndërtimit, e cila rezultoi në vlerën 11.951.407 lekë për ndërtimin e tri kateve. Nga analiza financiare për vitin 2004, që i përket ndërtimit të katit të parë teknik, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të krijonte pasurinë dhe të përballonte shpenzimet e jetesës për diferencën negative prej 2.981.367 lekësh.

**15.12** Kolegji vëren se pasaktësitë e subjektit të rivlerësimit në deklarin ndë vite lidhur me pjesën takuese të ndërtesës, duket se nuk janë të qëllimshme për sa kohë pasuria është deklaruar, edhe pse ishte akoma e palegalizuar dhe e paregjistruar në regjistrat e pasurisë së paluajtshme, po ashtu edhe në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar pjesën takuese në pjesë ideale të pandarë, në bashkëpronësi me bashkëshortin, vjehrrin dhe vjehrrën. Ky deklarin përputhet edhe me dokumentacionin e administruar në dosje, pasi rezulton se më datë 07.02.2011, me lejen e legalizimit nr. {\*\*\*}, është legalizuar objekti godinë banimi 3 kate, në emër të z. A. G. dhe z. D. G. dhe më pas e regjistruar po në vitin 2011, në emër të këtyre personave sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar. Pasaktësitë për pjesët takuese të pasurisë janë rregulluar me plotësimin e deklaratës *vetting*, ku subjekti ka deklaruar saktë këto pjesë, e cila përputhet dhe me dokumentacionin e administruar për këtë pasuri në dosjen e ardhur nga Komisioni.

**15.13** Subjekti i rivlerësimit në seancat publike në Kolegji, në parashtrimet dhe diskutimet përfundimtare, sqaroi se: *Në përllogaritjen e vlerës së ndërtesës deklaruar në deklaratën vetting, kam pasur parasysh se godina e banimit është ndërtuar ndër vite, nga viti 1997 e deri në vitin 2006, për këtë arsye llogaritjet e mija janë bazuar (me konsultën edhe të ekspertëve të fushës) në metodën që i përafrohet mënyrës së ndërtimit të saj, duke pasur në konsideratë vlerat e ç kam mesatar sipas zërave të punimeve për qytetin e Tiranës. Unë vlerësoj se për një ndërtim të kryer pjesë - pjesë nuk ka mundësi të aplikohen çmimet mesatare të banesave të përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banesave. [...] Në kushtet kur ky ndërtim është realizuar në mënyrë informale, pra nuk ka leje ndërtimi, as projekt, as preventiv etj., vlera e ndërtimit të shtëpisë duhet të llogaritet ashtu siç është llogaritur nga ana ime, pra sipas zërave të punimeve shumëzuar me çmimin mesatar të vlerave të këtyre zërave, për qytetin e Tiranës. Argumenti im mbështetet edhe nga vetë shkresa e lëshuar nga EKB, administruar nga KPK gjatë hetimit administrativ, në të cilën theksohet se në rastet e banesave informale nuk mund të ketë një vlerësim nga ky institucion. Gjithashtu Komisioni ka vlerësuar në përllogaritjet e kryera, edhe faktin që papafingo është karabina dhe për këtë fakt bazuar në aktet shkresore të lëshuara nga DRT dhe shoqata e ndërtuesve të Shqipërisë ajo do të konsiderohet në 44,1% të vlerës së plotë të ndërtimit.*

**15.14** Kolegji vëren se kostoja e përcaktuar nga ALUIZNI në momentin e legalizimit, në fakt, nuk është kostoja reale e shpenzimeve të objektit godinë 3-katëshe, por është e bazuar në koston mesatare të ndërtimit të banesave për metër katror, bazuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave

nr. 4, datë 23.11.2011, miratuar në zbatim të shkronjës “dh”<sup>3</sup> të nenit 34/1 të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar, mbi të cilin ALUIZNI kryen përlllogaritjen duke verifikuar vetëm sipërfaqen e ndërtimit dhe duke e shumëzuar me 0,5% (përqindja e aplikueshme e taksës) dhe me vlerën standarde të kostos mesatare të ndërtimit, rezulton çmimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë, taksë të cilën e ka paguar subjekti posedues i ndërtimit. Pra është një çmim fiks që i referohet vitit të legalizimit të ndërtesës (në këtë rast, vitit 2011), pavarësisht nga kostoja reale e ndërtimit dhe që shërben për përcaktimin e taksës së infrastrukturës, të cilën e paguan subjekti i legalizimit. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar çmimin prej 6.000.000 lekësh si vlerë e banesës në deklaratën *vetting*, që i referohet edhe koston reale të ndërtimit të kësaj prone dhe jo çmimit të rivlerësuar në momentin e legalizimit.

**15.15** Në Kolegj u krye analiza financiare për të llogaritur koston e kateve të godinës bazuar në të dhënat e EKB-së për koston e ndërtimit. Për përlllogaritjen e vlerës së papafingos, sipas deklaramëve mbi gjendjen karabina dhe pretendimit të subjektit të rivlerësimit që t’i konsiderohet kati i papafingos me 44,1% të vlerës së plotë të ndërtimit, si dhe bazuar në vendimmarrjen e Kolegjit<sup>4</sup> për përlllogaritjen e vlerës së karabinasë, rezultoi se vlera e katit të parë teknik dhe papafingos ka kushtuar 6.554.829 lekë.

**15.16** Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës, gjatë seancave publike në Kolegj, argumentoi: [...] *Dëshiroj të sjell edhe një herë në vëmendje të këtij trupi gjykues se, familjes time dhe këtu nën kuptoj jo familjen të pasqyruar në certifikatat e gjendjes civile por familjen e vërtetë jetën tonë të jetuar, nën një çati, në një ekonomi të përbashkët të pandarë, nuk i është bërë analiza e duhur e situatës faktike, e thënë me fjalë të tjera dy prindër mjaft të nderuar që jetën e tyre e kanë nisur në martesë në vitet 1970, të përkushtuar në rritjen dhe edukimin e katër fëmijëve të mrekullueshëm, ku unë pata fatin të jem nusja e djalit të tyre të vetëm, u starton jeta në vitin 1995 kur djali i tyre D. martohet. Familja ka dhënë kontribut të pandashëm në ndërtimin dhe krijimin e kësaj pasurie dhe çdo pasuri që është vendosur në këto vite, ndaj në respekt të viteve, lodhjeve, halleve, gëzimeve që mbajnë mbi supë këta prindër, do të doja një vlerësim të drejtë dhe real në pozitën procedurale si persona të lidhur. Në fakt këtu është e kundërta sepse në këtë familje unë kam hyrë nuse dhe person i lidhur për shkak të martesës jam unë, e thënë me fjalë të tjera, nëse nesër unë divorcohem nga im shoq, ata janë bashkë dhe përsëri një familje. Në këtë kuptim, më së pari situata faktike duhet të marrë një kuptim të qartë që mandej të bëhen edhe analizat financiare mbi burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive. [...] Në këtë balancë. duhet të paktën KPA të marrë në konsideratë faktin se vjehri me vjehrrën janë persona të tjerë të lidhur, sipas përcaktimit të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton se: “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që*

<sup>3</sup> Neni 34/1, shkronja “dh” e ligjit nr. 9232/2004 “përcakton koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave, në kuadër të programeve të këtij ligji, e cila miratohet çdo vit me udhëzim të Këshillit të Ministrave”.

<sup>4</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 22/2020 (JR), datë 16.09.2020, paragrafi nr. 55.

*rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Mbi personat e lidhur tanimë ka një praktikë të konsoliduar të KPA-së mbi mënyrën e llogaritjes dhe analizës financiare të tyre.*

**15.17** Kolegji vëren se udhëzimi i Inspektorit të Lartë të ILDKPKI-së nr. {\*\*\*} prot., datë 10.10.2016, parashikon shprehimisht në pikën 8: *Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor, kontratë shitblerjeje, kontratë sipërmarrjeje, aktmarrëveshje, kontratë paraprake, kontratë porosie etj., dhe certifikatën e pronësisë në rastet kur prona është e regjistruar në ZVRPP.* Referuar edhe qëndrimin në vendimmarrjen (vendimi nr. 14/2021 (JR), datë 15.06.2021) e Kolegjit, pasuritë në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t trajtohen veçmas në pikën 9 të të njëjtit udhëzim, sipas të cilit deklarimi i tyre në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar duhet të shoqërohet me kopje të të gjithë dokumentacionit të paraqitur pranë ALUIZNI-t. Kjo pikë e udhëzimit lidhet konkretisht me pasuritë të cilat në momentin e deklarimit, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, janë në posedim apo përdorim të subjektit të rivlerësimit apo të personave të lidhur me të, kërkesë kjo e cila ndryshe nga detyrimi për deklarim periodik, është përcaktuar për herë të parë në procesin e rivlerësimit kalimtar, në zërbërje të parashikimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës. Ky detyrim i ka lindur në momentin e fitimit të pronësisë, që në rastin konkret është leja e legalizimit, të cilën subjekti e ka deklaruar saktësisht në DIPV-në përkatëse, dhe madje në deklaratën *vetting*.

**15.18** Për sa i përket ndërtimit të katit të parë teknik, vlera e ndërtimit të këtij kati rezulton në shumën 4.412.503 lekë. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, gjatë seancave gjyqësore publike në Kolegji, argumentoi se ky kat është ndërtuar gjatë viteve 2004 dhe 2005. Në DIPV-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjë shpenzim për sa i përket ndërtimit të katit të parë teknik dhe, si e tillë, analiza ekonomike për ndërtimin e këtij kati është kryer duke e konsideruar si të ndërtuar në vitin 2004. Në dokumentacionin e administruar në dosje, ka gjurmë të një kredie e cila rezulton se është marrë për ndërtimin e shtëpisë dhe gjithashtu është tërhequr me tri pjesë, në vitet 2004, 2005 dhe 2006. Në analizën e kryer në Kolegji nuk u mor parasysh pretendimi i subjektit të rivlerësimit për ndarjen e kostove të ndërtimit në tri vite të ndryshme, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën përkatëse të vitit 2005 asnjë ndryshim të pasurisë godinë banimi.

**15.19** Në analizën financiare mbi mundësinë e ndërtimit të papafingos të banesës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon të theksojë se edhe nëse analiza financiare do të kryhej në një qëndrim tejet garantist duke përllogaritur koston e ndërtimit të saj me 44,1% të vlerës së plotë të ndërtimit siç e ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, bazuar edhe në të dhënat e EKB-së, kati i papafingos karabina rezultoi në vlerën 2.142.326 lekë. Situata ekonomike e vitit 2006, duke konsideruar ndërtimin në gjendjen karabina të papafingos, do të rezultonte me një diferencë negative për mundësinë e ndërtimit të papafingos në vlerën 585.022 lekë.

- 16.** *Lidhur me pasurinë “truall me sipërfaqe 437,6 m<sup>2</sup>”, parcelë ndërtimore e godinës së banimit me tri kate, Komisioneri Publik pretendon se në analizën financiare të vitit 2010, duhet të përfshihen vetëm të ardhurat e prindërve të bashkëshortit të subjektit, si dhe shpenzimet e jetesës familjare,*

duke përfshirë edhe këta të fundit. Komisioneri Publik pretendon se shuma prej 1.280.000 lekësh (e tërhequr në *cash* nga llogaria pranë Tirana Bank, në datën 11.02.2009, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), likuiditetet e pretenduara se janë gjendje *cash* në banesë, por që nuk janë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2009, nuk duhet të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme për vitin 2010.

**16.1** Në deklaratën *vetting*, kjo pasuri është deklaruar: *Blerje e truallit të banesës nga ALUIZNI [...]. Vlera përbëhet nga 2.040.000 lekë bono privatizimi, 1.989.510 lekë, dhe 75.989 lekë pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

Në deklaratën periodike të vitit 2010, kjo pasuri është deklaruar: *Blerje e truallit të banesës nga ALUIZNI [...]. Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë të banesës, shumë e paguar nga bashkëshorti dhe vjehrri. Vlera 2.040.000 bono privatizimi, 1.989.510 lekë.*

**16.2** Nga verifikimi i akteve në dosjen e përcjellë nga Komisioni, konstatohet se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, sa më sipër, mbështeten nga kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 06.12.2010, me palë shitëse {\*\*\*} dhe palë blerëse shtetasit A. G. dhe D. G., me objekt kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore me sipërfaqe prej 437,6 m<sup>2</sup>, me çmim: (1) taksë e ndikimit në infrastrukturë 75.989 lekë; (2) parcelë ndërtimore 1.989.510 lekë; (3) parcelë ndërtimore letra me vlerë -280.000 lekë + 1.860.000 lekë; (4) penalitet dhe deklarim me vonesë -8.752 lekë. Nga verifikimi i akteve në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të saktë për sipërfaqen e parcelës ndërtimore dhe vlerën e paguar për të.

**16.3** Në parashtrimet e paraqitura në seancë publike në Kolegj, subjekti i rivlerësimit lidhur me mosdeklarimin e gjendjes *cash* argumentoi: *[...] Pavarësisht se kemi jetuar në një ekonomi të përbashkët familjare, prindërit e bashkëshortit nuk kanë qenë subjekte deklaruese. Në të gjitha deklaratat e pasurisë, nga viti 2003-2015, unë nuk kam deklaruar gjendje cash. Për herë të parë gjendjen cash në banesë e kam pasqyruar në DPV 2016. E kam shpjeguar se në vitin 2015, kunata ime, znj. B. M. (G.), është ndarë nga bashkëshorti dhe jeton që prej asaj kohe edhe sot në familjen tonë, në këto kushte familja jonë u nda ekonomikisht pasi prindërit e bashkëshortit ekonomikisht tani janë me vajzën e tyre. Që prej vitit 2016, unë kam deklaruar gjendje cash në banesë. Pra, në mënyrë të përmbledhur, mosdeklarimi i gjendjes cash ka ardhur si rezultat i dy faktorëve kryesorë: a) mënyra organizimit të jetës sonë familjare dhe menaxhimit të të ardhurave. Të dy ata së bashku, të ardhurat familjare i administronin për shpenzime jetese dhe kursimet e mundshme do të përdorehin për krijimin e pasurive; b) faktit që vjehrri nuk ka qenë subjekt deklarues. Pra, që do të thotë se gjendje cash nuk do të më konsiderohet mua si subjekt deklarues, por vjehrri im ka pasur gjendje cash të akumuluar ndër vite, vlerë e cila do të duhet të merret në konsideratë nga ky i nderuar trup gjykues në analizën financiare.*

**16.4** Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer veprimet e mëposhtme në Bankën Procredit: në datën 16.06.2010, ka depozituar shumën 500.500 lekë *cash*. Në datën 30.10.2010, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar në Procredit Bank shumën 1.500.000 lekë *cash*, me emërtesë “të ardhura nga paga për pagesë ALUZINI”. Nga ekstrakti bankar i llogarisë së bashkëshortit të subjektit të



rivlerësimit në Tirana Bank, rezulton se duke filluar nga shkurti 2008, nga D. G. janë kryer 8 depozitime *cash* me shumë totale 582.000 lekë. Në këtë llogari, gjendja nga viti 2007 ishte 639.000 lekë. Çdo shumë e depozituar gjatë vitit 2008, është investuar në depozita afatshkurtra, në të njëjtën datë të depozitimit të *cash*-it përkatës. Në datën 11.02.2009, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka tërhequr *cash* shumën 1.281.000 lekë, e cila është maturim i depozitës me afat.

**16.5** Lidhur me burimin e ligjshëm për pagesën e truallit, Komisioni ka kryer analizën financiare të vitit 2010, për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme pagesën e truallit në vlerën 1.989.510 lekë, sipas mandatpagesave dhe vlerën 300.000 lekë bono privatizimi (mbështetur vetëm në deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, në mungesë të provave të paraqitura nga ana e tij). Nga kjo analizë për vitin 2010, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme shpenzimet e jetesës, pagesës së truallit dhe legalizimit dhe ndryshimet në likuiditetet bankare, për një diferencë negative në shumën -1.279.525 lekë.

**16.6** Lidhur me këtë rezultat, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, së cilës subjekti iu përgjigj duke sqaruar se: *Mosqenia e dy kurorave në një certifikatë familjare nuk përjashton kontributin e secilit bashkëpronar në blerjen e truallit. [...] për këtë shkak, kërkohet që analiza financiare e vitit 2010 të rishikohet duke marrë në konsideratë të ardhurat, kontributin e familjes së vjehrrit, për kontributin e vlerës së blerjes së truallit.*

**16.7** Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe për të kryer pagesën e truallit për vlerën -1.120.450 lekë. Subjekti i rivlerësimit, depozitimin e shumës 1.000.000 lekë, në Procredit Bank, e ka deklaruar në deklaratën e vitit 2010, ku ka deklaruar: *Depozitë në emër të bashkëshortit në Bankën Procredit, në datën 27.01.2010, u mbyll depozita në bankën Tirana Bank dhe u hap këtu.*

**16.8** Nga sa më sipër, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte deklaruar shumën e tërhequr në vitin 2009 nga Banka Tirana në deklaratën periodike të vitit 2009. Mosdeklarimi i kësaj shume në kohë, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, sjell pamundësinë e kryerjes së kontrollit dhe vlerësimit të kësaj situate sipas përcaktimeve në legjisllacionin e zbatueshëm në fuqi për rivlerësimin kalimtar, duke i lënë pretendimet e subjektit të rivlerësimit në nivelin e deklaratimeve, vërtetësia e të cilave mbetet e pamundur për t’u verifikuar. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për këtë pasuri, ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për ta justifikuar krijimin e saj. *Sa më sipër, shkak i ankimit i Komisionerit Publik gjendet i bazuar.*

- 17. Njësi me sip. 25,7 m<sup>2</sup> me adresë rruga “{\*\*\*}” Tiranë,** për të cilën Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe rrjedhimisht nuk mbulon me burime të ligjshme shumën prej 1.000.000 lekësh, si pjesë e krijimit të depozitës së përdorur për blerjen e pasurisë “Njësi me sip. 25,7 m<sup>2</sup>, me adresë: rruga “{\*\*\*}”, Tiranë.

Gjithashtu Komisioneri Publik pretendon se mbetet e paprovuar mundësia financiare e personit tjetër të lidhur, për të mbuluar me burime të ligjshme shumë e dhënë hua subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të.

**17.1** Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Në përfundim të kësaj analize, konkludohet se, bazuar në dokumentacion e administruar gjatë hetimit administrativ, znj. B. M., ka pasur të ardhura të mjaftueshme për t'i dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumë 1.800.000 lekë. Në përfundim të analizës për këtë pasuri, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë pasurinë dyqan, duke përdorur si burim të ardhurash depozitat në bankë, si dhe huan e marrë nga motra e bashkëshortit.*

**17.2 Në deklaratën vetting**, është deklaruar: “Dyqan njësi me nr. {\*\*\*}, me sip. 25,70 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Burimi i deklaruar: E blerë nga të ardhurat e familjes, të ndodhura në depozita në bankë (të krijuara nga paga, qiratë dhe shitja e makinave) dhe hua e marrë nga motra e bashkëshortit në vlerën 1.800.000 lekë, kaluar 1.650.000 lekë në llogarinë e deklarueses në po atë datë, Procredit Bank, ndërsa 150.000 lekë jashtë banke, hua e cila është shlyer në vitin 2013, nëpërmjet Procredit Bank, sipas mandatpagesave. Shuma e deklaruar 5.474.100 lekë. Pjesa takuese: 50%”.

**Në DIPP-në e vitit 2012**, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “Dyqan me sip. 25,70 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. [...] Vlera 5.474.100 lekë, kaluar me transfertë bankare nga Procredit Bank në ICB, pa deklaruar burimin e krijimit të saj. Në të njëjtën deklaratë, subjekti deklaroi huan ndaj kumatës B. G., në shumë 1.800.000 lekë, për blerjen e dyqanit, nga të cilat janë dhënë 1.650.000 lekë me bankë, ndërsa pjesa tjetër në dorë.

**Në DIPP-në e vitit 2013**, subjekti deklaroi shlyerjen e detyrimit ndaj motrës së bashkëshortit.

**17.3** Pasi dëgjoi Komisionerin Publik, trupi gjyqësor i Kolegjit mori në analizë aspektet e tjera të këtij shkakut ankimi, duke u qëndruar më tej pretendimeve për mbulimin me burime të ligjshme të shumë prej 1.000.000 lekësh.

**17.4** Sa i përket pjesës së shkakut të ankimit në lidhje me krijimin e depozitës nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në janar të vitit 2010, nga tërheqja e depozitës së vitit 2009, siç është shpjeguar edhe në shkakun e dytë të pasurisë “truall” më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009, gjendje *cash* në banesë pas tërheqjes së depozitës gjatë këtij viti. Subjekti në DIPP-në e vitit 2010 ka deklaruar krijimin e kësaj depozite dhe gjithashtu ka shpjeguar se kjo depozitë është krijuar pas tërheqjes së depozitës së mëparshme në vitin 2009. Si rrjedhojë, nga analiza financiare, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për çeljen e depozitës në vitin 2010 në ProCredit Bank, duke mos mbuluar me burime të ligjshme shumë prej 1.000.000 lekësh, si pjesë e krijimit të depozitës së përdorur si burim për blerjen e pasurisë “Njësi me sip. 25,7 m<sup>2</sup>, me adresë: rruga “{\*\*\*}”, Tiranë”.

**18.** Lidhur me pasurinë “autoveturë Mercedes Benz ML”, me targë {\*\*\*}, Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që në kuadër të ligjit 9049/2003, të deklarojë ndryshimet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë dhe likuiditetet *cash*, në fund të

çdo viti kalendarik. Në përfundim për këtë pasuri, në mungesë të përmbushjes së detyrimit ligjor për deklarimin e shtesave apo pakësimeve të likuiditeteve *cash*, subjekti i rivlerësimit nuk provoi gjendjen *cash* në fund të vitit 2008, apo në janar të vitit 2009, si rrjedhojë nuk provoi mbulimin me të ardhura nga burime të ligjshme të shumës 5.000 euro ose 615.000 lekë në janar të vitit 2009.

**18.1** Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Në përfundim të hetimit në lidhje me këtë automjet, duke marrë në konsideratë faktin se viti 2009 rezulton me një bilanc pozitiv në shumën 1.495.769 lekë, për vitet 2006 – 2009 me një bilanc në total 623.697 lekë, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie në raport me provat e tjera të administruara nëpërmjet hetimit, Komisioni vlerëson se mungesa e të ardhurave për pagesën e kështit të dytë të automjetit, nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61.*

**18.2** Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Bashkëshorti ka blerë një automjet me vlerë 12.000 euro. Paguar në datë 18.08.2008, shuma prej 7.000 eurosh.* Në rubrikën e detyrimeve financiare të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar detyrimin ndaj shitësit të automjetit në vlerën 5.000 euro. Në asnjë nga rubrikat subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi kursime *cash* për këtë vit.

Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *Detyrimi ndaj shitësit F. N., shlyer me deklaratën e datës 07.01.2009, shuma e shlyer 5.000 euro.*

**18.3** Kolegji vëren se nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e përcjellë nga Komisioni, konstatohet se mungon kontrata e shitjes për këtë automjet, ndërsa deklaratat noteriale të datave 01.08.2008 dhe 07.01.2009 nuk janë në harmoni me dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRR”). Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë automjet në vitin 2008, ndërsa në dokumentacionin e dosjes së ardhur nga DPSHTRR-ja, ky automjet referohet se ka hyrë në Shqipëri më datë 29.07.2009. Në deklaratën noteriale, datë 07.01.2009, me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., deklarohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka paguar shumën 5.000 euro deklaruesit F. N. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar kursime *cash* në DIPP-në e vitit 2008, për rrjedhojë ajo nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar shumën 5.000 euro për blerjen e kësaj makine. Në dosjen e ILDKPKI-së gjendet edhe një kontratë huapërdorje e lidhur ndërmjet huadhënësit A. N. (babai i F. N.) dhe huapërdoruesit D. G., nëpërmjet së cilës huadhënësi që ka në pronësi këtë automjet, ia jep huapërdoruesit për ta përdorur brenda dhe jashtë vendit për periudhën nga 29.07.2008 deri më 29.07.2009. Data e përfundimit të kësaj huapërdorjeje është dhe data që ka hyrë mjeti në Shqipëri. Më datë 16.04.2015, me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., ky automjet është shitur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për shumën 6.000 euro.

**18.4** Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit vetëm për mospasjen e mundësisë për të paguar vlerën prej 5000 eurosh për blerjen e kësaj makine. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se: *Në lidhje me këtë konstatim, shpjegoj se në të gjitha deklaratat e pasurisë nga viti 2003-2015 unë nuk kam deklaruar gjendje cash. Për herë të*

*parë kam deklaruar cash në vitin 2016. Ky mosdeklarim i gjendjes cash ka ardhur për shkak të mënyrës së menaxhimit të të ardhurave. Unë pagën siç e merrja, ia dorëzoja bashkëshortit, dhe ai rrogën time dhe rrogën e tij ia dorëzonte babait të tij. Të dy ata së bashku të ardhurat familjare i administronin për shpenzime jetese dhe krijimin e pasurive. Pavarësisht mosdeklarimit të gjendjes cash në fund të çdo viti, gjendja jonë ekonomike nuk ka qenë zero.*

**18.5** Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në seancat publike në Kolegj lidhur me këtë shkak ankimi se: *Theksoj edhe një herë se në të gjitha deklaratat e pasurisë për vitet 2003 – 2015 nuk kam deklaruar gjendjen cash. Për herë të parë gjendjen cash në banesë e kam pasqyruar në DPV-në e vitit 2016. Pavarësisht mosdeklarimit të gjendjes cash në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, viti pasardhës, pra, pas datës 31 dhjetor, gjendja cash, në familjen time nuk ka qenë zero lekë. Pra, në datën 1 janar të çdo viti, familja kishte likuiditete të cilat i administronte i pari i shtëpisë, vjehrri. Bilanci i viteve paraardhëse minimalisht 2007 dhe 2008 janë pozitivë në një vlerë të konsiderueshme, për këtë arsye duhet që vlerat që dalin si mundësi kursimi, të merren në konsideratë si gjendje cash nga të ardhurat e ligjshme në banesë, të administruara nga babai i bashkëshortit.*

**18.6** Kolegji vëren se në shkresën nr. {\*\*\*} prot. datë 06.12.2019, të Drejtorisë së Tatimeve specifikohet se për vitin 2011 është paguar tatimi 324.000 lekë për të ardhurat bruto 3.240.000 lekë, për vitin 2012 është paguar tatimi 44.000 lekë për të ardhurat bruto 444.444 lekë, për vitin 2013 është paguar tatimi 29.667 lekë për të ardhurat bruto 296.667 lekë, për vitin 2015 është paguar tatimi 24.900 lekë për të ardhurat bruto 166.000 lekë dhe për vitin 2016 është paguar tatimi 29.647 lekë për të ardhurat bruto 197.647 Lekë. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte ekzistencën e marrëdhënieve të qirave për të cilat janë paguar me vonesë detyrimet tatimore, për këtë shkak, kjo pagesë nuk ka pasur efekt në drejtim të provueshmërisë dhe ligjshmërisë së të ardhurave. Duke qenë se subjekti ka referuar në parashtrimet e dorëzuara në seancë publike vendimin nr. 15/2021 (JR), datë 18.06.2021, të Kolegjit duke e krahasuar si praktikë në të cilën ndodhet në të njëjtat kushte, Kolegji çmon se ky orientim nuk mund të zbatohet në këtë rast, pasi më parë duhen konsideruar disa rrethana, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Subjekti i rivlerësimit, i nxitur nga rezultatet paraprake të hetimit, e ka paguar tatimin mbi këto të ardhura përpara dhënies së vendimit të Komisionit, por pas dorëzimit të deklaratës *vetting*. Në praktikën<sup>5</sup> e konsoliduar të Kolegjit, është mbajtur qëndrim se, bazuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon: [...] *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...]*, ndaj për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative këto dy kritere: (i) që janë deklaruar dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi, si rrjedhojë Kolegji

---

<sup>5</sup> *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2019 (JR), datë 28.02.2019, paragrafi 21.12; nr. 23/2020 (JR), datë 25.09.2020, paragrafi 25.4.*

vlerësoi të mos konsiderohen si të ligjshme të ardhurat nga qiratë apo puna *part time* e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

**18.7** Në përfundim të analizës së këtij shkakut ankimi, Kolegjit i rezultoi se gjatë vitit 2008, subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij mund të përballonin shpenzimet e jetesës dhe blerjen e pasurive për vitin 2008. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur të ardhura deri në datën 07.01.2009, në vlerën 140.000 lekë, vlerë e cila nuk është e mjaftueshme për të përballuar pagesën e kësaj pasurie, në vlerën 5000 euro, konvertuar<sup>6</sup> në vlerën 624.400 lekë, si rrjedhojë subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për këtë pasuri ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar krijimin e saj. *Sa më sipër, shkakut i ankimit të Komisionerit Publik, gjendet i bazuar.*

- 19.** *Lidhur me pasurinë “automjet tip Peugeot”, me targë {\*\*\*}, në emër të personit të lidhur D. G., Komisioneri Publik pretendon se analiza financiare përfundimtare e Komisionit, paraqitur në vendim, i përket periudhës janar 2014 - dhjetor 2014, kur në fakt duhej t’i referohej së njëjtës periudhë për të cilën subjektit iu kalua barra e provës, për të provuar të kundërtën, pra periudhës 01.01.2014 – 25.08.2014. Si rrjedhojë, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të dhe shpenzimet, duhet të analizohen për këtë periudhë duke mos përfshirë të ardhurat nga qiradhënia, detyrimet tatimore të të cilave janë paguar gjatë procesit administrativ, si dhe në zërin e shpenzimeve duhet të përfshihen shpenzime shkollimi, në shumën 1.620 euro, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2014 dhe të kryera në periudhën janar – qershor 2014.*

**19.1** Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Pas përfshirjeve të këtyre të ardhurave, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “Peugeot”. Subjekti ka qenë i saktë në deklaratën e tij në deklaratën “vetting”.*

**19.2** Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, djali D. G., ka deklaruar: *makinë, marka “Peugeot”, blerë me kontratën nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 15.08.2014. Burimi: nga të ardhurat e familjes. Vlera: 270.000 lekë.*

Në DIPP-në e vitit 2014, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka deklaruar: *blerje makine në emër të djalit D. G., kontrata e shitblerjes datë 15.08.2014, nga të ardhurat e prindërve, në vlerën 270.000 lekë.*

**19.3** Kolegji vëren se, me kontratën e shitblerjes së automjetit me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 25.08.2014, djali i subjektit të rivlerësimit D. G. ka blerë automjet tip “Peugeot” në vlerën 270.000 lekë. Komisioni ka kryer analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nëse mbulojnë me të ardhura të ligjshme shpenzimet e kryera për blerjen e kësaj pasurie, duke përfshirë shpenzimet e tjera të kryera për këtë periudhë, si dhe kursimet e krijuara dhe të depozituara në sistemin bankar. Nga analiza financiare në Komision, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet deri në këtë moment, për një diferencë negative në shumën -714.747 lekë. Në lidhje me këtë diferencë, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

---

<sup>6</sup> Me kursin historik të Bankës së Shqipërisë, të datës 07.01.2009.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: [...] *sapo kam konstatuar këtë fakt, kam marrë masa për pagimin e tatimit në burim, sikundër vërtetohet në vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 06.12.2019, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.*

**19.4** Subjekti i rivlerësimit, në seancat publike në Kolegj, ka parashtruar lidhur me këtë shkak ankimi se: *Ndryshe nga sa pretendon Komisioneri Publik në ankim, kjo shumë e krijuar nga dhënia me qira e ambientit, është e ligjshme dhe, si e tillë, duhet të përfshihet te analiza financiare e vitit 2014 pasi sikundër provohet nga aktet në dosje, ne kemi lidhur rregullisht kontratat e qirasë me personat të cilët kanë marrë me qira ambientin, duke përcaktuar qartësisht në kontratë detyrimin ligjor të pagimit të vlerës së tatimit mbi vlerën mujore të qirasë. Ky detyrim me ligj është përcaktuar se i takon qiramarrësit dhe jo qiradhënësit. Bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nenin 33, germa “ë”, të gjithë tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitetet, duhet të dorëzojnë në Drejtorinë Rajonale Tatimore një kopje të kontratës së qirasë apo të kontratës së pronësisë së ambientit. Në zbatim të dispozitës ligjore të sipërpërmendur, tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitetet në ambientet e marra me qira, duhet të llogaritin, mbajnë dhe derdhin për llogari të organeve tatimore, tatimin në burim deri në datën 20 të muajit pasardhës të kryerjes së pagesës së qirasë.*

**19.5** Në Kolegj, bazuar në shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, u krye analiza financiare për subjektin e rivlerësimit dhe familjen e tij për vitin 2014, nga e cila rezultoi se diferenca negative është të paktën sa diferenca negative e përlllogaritur nga Komisioneri Publik. Ky vit u fragmentua duke u analizuar, si fillim, deri në momentin e blerjes së pasurisë, pra deri në datën 25.08.2014 dhe, më pas, u analizua i plotë nga janari në dhjetor. Të ardhurat e familjes së subjektit të rivlerësimit përbëhen nga të ardhurat nga paga e tij sipas vërtetimeve të institucioneve përkatëse, të ardhurat nga puna e bashkëshortit të tij sipas vërtetimeve përkatëse nga institucione, si: AMA<sup>7</sup>, ACREM<sup>8</sup> dhe SERE<sup>9</sup>. Sa u përket të ardhurave nga qiratë, janë vendosur të ardhurat nga dyqani dhe shtëpia bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucionet tatimore. Për të ardhurat e qirasë së shtëpisë, janë përlllogaritur vetëm të ardhurat për vlerën e të cilave është paguar tatimi, përpara dorëzimit të deklaratës *vetting*, sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, me nr. {\*\*\*} prot., datë 01.08.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit, në të cilën vërtetohet se për të ardhurat nga qiraja e shtëpisë është paguar tatimi vetëm për vitin 2014, në vlerën 9600 lekë. Sa u përket të ardhurave nga shtëpia, subjekti nuk provoi ekzistencën e marrëdhënies së qirasë dhe as vlerat e përfituara prej kësaj marrëdhënieje, me përjashtim të asaj për të cilën janë paguar detyrimet tatimore. Në lidhje me qiratë e dyqanit, përderisa rezultoi se subjekti ka pasur detyrimin sipas kontratave të qirasë, për pagimin e detyrimeve tatimore, pagimi jo në kohë i tyre tregon për moszbatimin e këtij detyrimi ligjor prej subjektit në kohën kur ai ka lindur, për pasojë pagimi me vonesë i këtij detyrimi, në referim të vendimit nr. 15/2021, datë 18.06.2021, të Kolegjit, nuk e shëron paligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

<sup>7</sup> Autoriteti i Mediave Audiovizive.

<sup>8</sup> Singapore Europe Real Estate.

<sup>9</sup> Albanian Commercial Real Estate Management.

19.6 Në përfundim të analizës financiare, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të krijonte pasurinë automjet (“Peugeot”) për djalin e tij, të investonte në fondin *Prestige*, të krijonte/mbante likuiditete bankare dhe të përballonte shpenzimet e jetesës deri në datën 25.08.2014, për diferencën negative 582.072 lekë. Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të të ardhurave të ligjshme për të gjithë vitin 2014, me një diferencë negative në shumën 108.623 lekë. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar krijimin e pasurisë automjet në vitin 2014. *Sa më sipër, shkaku i ankimit i Komisionerit Publik gjendet i bazuar.*

20. *Lidhur me kursimet në cash, në shumën 1.400.000 lekë, deklaruar në DIPP-në e vitit 2016, Komisioneri Publik ka pretenduar se përfshirja e të ardhurave nga qiraja për shumën prej 168.000 lekësh për vitin 2016, nuk përputhet me dokumentacionin e depozituar në dosje të subjektit të rivlerësimit, konfirmimin nga Drejtoria Rajonale Tatimore<sup>10</sup> mbi të ardhurat e realizuara nga qiradhënia për të cilat janë shlyer dhe detyrimet tatimore në kohën e realizimit të këtyre të ardhurave. Rezulton se për të ardhurën e deklaruar në vlerën 168.000 lekë, subjekti ka shlyer detyrimet tatimore vetëm pas kalimit të barrës së provës nga ana e Komisionit, ndaj këto të ardhura, në vlerësimin e Komisionerit Publik, nuk duhet të përfshihen në burimet e ligjshme të krijimit të pasurive. Gjithashtu Komisioneri Publik vlerëson të pambështetur në akte edhe rishikimin e shpenzimeve të shkollimit nga ana e Komisionit.*

20.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Komisioni ka marrë në konsideratë të ardhurat nga qiraja, pasi është vërtetuar pagimi i detyrimeve tatimore, si dhe shpenzimet e shkollimit janë reduktuar në masën që të përfshihen në shpenzimet e jetesës. Nga analiza financiare, konstatohet se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen cash.*

20.2 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar kursime në *cash* në shumën 1.400.000 lekë. Nga analiza e Komisionit për vitin 2016, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për këtë vit për një diferencë negative prej 191.825 lekësh. Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve për krijimin e gjendjes *cash*. Nga verifikimi i akteve në dosje, referuar analizës financiare të Komisionit në rezultatet paraprake të hetimit dhe analizës së pasqyruar në vendimin e arsyetuar, konstatohet se Komisioni ka rishikuar disa nga zërat e analizës, si të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga paga dhe të ardhurat nga qiraja e dyqanit.

20.3 Nga dokumentacioni<sup>11</sup> i administruar në dosje, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paguar tatimet e të ardhurave për vitet 2011, 2012, 2014, 2015 dhe 2016 të deklaruara në bazë të formularit të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave që përfshijnë tatim qiraje dhe të ardhura bruto. Nga analiza e rishikuar që ka kryer Komisioni pas sjelljes së

<sup>10</sup> *Shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, nr. {\*\*\*} prot., datë 01.08.2019.*

<sup>11</sup> *Shkresë e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me nr. {\*\*\*}, datë 06.12.2019.*

dokumentit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, që janë paguar tatimet për të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga shoqëria {\*\*\*} dhe të ardhurat nga qiraja duke përfshirë këto të ardhura në analizën financiare, rezultati financiar i vitit 2016, Komisionit i rezultoi pozitiv.

**20.4** Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se sa u përket të ardhurave nga qiraja e banesës të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, nga aktet e administruara në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka depozituar dy kontrata qiraje, përkatësisht kontratë nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 17.10.2014, me afat 1-vjeçar, i cili fillon më datë 01.07.2014, në shumën 16.000 lekë dhe kontratë, datë 01.08.2015, me afat 1-vjeçar në shumën 14.000 lekë. Në dosjen e administruar në Kolegj, rezulton shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me nr. {\*\*\*} prot., datë 01.08.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit, në të cilën specifikohet se për të ardhurat nga qiraja e shtëpisë është paguar tatimi vetëm për vitin 2014 në vlerën 9600 lekë. Të ardhurat nga qiradhënia e shtëpisë nuk janë konsideruar në analizën financiare të kryer në Kolegj, referuar edhe vendimmarrjes së konsoliduar të Kolegjit duke iu referuar poshtëshënimit nr. 5, duke qenë se për to është shlyer detyrimi tatimor gjatë procesit të rivlerësimit. Në analizë janë konsideruar vetëm të ardhurat nga qiradhënia e dyqanit, për të cilat janë shlyer detyrimet tatimore, përpara dorëzimit të deklaratës *vetting*, sipas vërtetimeve të institucioneve përkatëse. Kolegji vlerësoi se marrëdhënia e qirasë për banesën mbeti e paprovuar, ndaj këto të ardhura nuk mund të legjitimohen nëse subjektet, personat e lidhur apo personat e tjerë të lidhur kanë qenë në kushte keqbesimi për sa i përket detyrimit për tatime për të ardhurat e tyre. Për shkak të këtyre elementeve, pagesa e tatimit me vonesë nuk e ka shëruar këtë mangësi.

**20.5** Në përfundim të sa më sipër, nga analiza financiare në lidhje me mundësinë e krijimit të pasurisë likuiditete në vitin 2016, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamjaftueshmëri financiare në shumën 149.448 lekë. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar krijimin e këtyre likuiditeteve në vitin 2016. *Sa më sipër, shkak i ankimit gjendet i bazuar.*

21. *Lidhur me mosdeklarimin e përdorimit të autoveturës me targa {\*\*\*}, për të cilën Komisioneri Publik në ankim fillimisht ka pretenduar se qëndrimi i Komisionit në drejtim të elementeve subjektive të dashjes e qëllimit, është në kundërshtim me qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në vendimet (JR) nr. 7/2018 dhe JR nr. 9/2019, pasi polica e sigurimit rezulton e prerë në tri periudha, nga ku ajo e fundit është 1-vjeçare, ndryshe nga sa referon Komisioni, si dhe nuk është deklaruar trajtimi preferencial në DIPP-në e vitit 2016 dhe DIPP-në e vitit 2017. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, në lidhje me këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik nuk u qëndroi më këtyre pretendimeve duke e konfirmuar në seancën gjyqësore publike në Kolegj të datës 09.11.2021.*

*Lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e aftësive profesionale*

22. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësive profesionale të kryer nga



KL Gj-ja dhe dokumentacionin bashkëlidhur; (ii) vlerësimin të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; (iii) kriteret të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilat është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional. Ndërsa sa u përket denoncimeve të ardhura nga publiku ka rezultuar:

23. *Lidhur me denoncimin anonim*, i protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.01.2020, në të cilin pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje të shoqërisë "{\*\*\*}" ShA, duke qenë njëkohësisht dhe aksioner i kësaj shoqërie, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara në pikën 1 të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, pasi në momentin e shqyrtimit të këtyre rasteve ku subjekti ka pasur interes për arsye se dispononte aksione në shoqërinë "{\*\*\*}" ShA, palë në këtë proces gjyqësor, bazuar në nenin 73 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të kishte hequr dorë nga gjykimi i këtyre çështjeve, veprim të cilin nuk e ka bërë. Komisioneri Publik pretendon se konflikti i interesit është një situatë që prek edhe pjesën etike të një magjistrati, veçanërisht në kontekstin përsëritës si në rastin e znj. Gazidedja, fakt i cili duhet të kishte drejtuar Komisionin në një konkluzion ndryshe në zbatim të nenit 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2018.

**23.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë çështje:** [...] duke marrë në konsideratë rezultatet e hetimit në lidhje me aksionet që ka pasur në pronësi subjekti dhe familjarët e saj në shoqërinë "{\*\*\*}" ShA, rezulton se subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, por bazuar në dy vendimet objekt gjykimi, nuk rezulton që të ketë favorizuar këtë shoqëri, si dhe duke marrë në konsideratë faktin që së bashku me familjarët e saj kanë pasur në pronësi aksione në vlerë të papërfillshme, si dhe nuk kanë përfituar asnjëherë dividend, ky konflikt interesi në dukje nuk përbën shkak për ta klasifikuar sipas nenit 65/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk kanë ardhur pasoja për palët. Në përfundim, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, pasi ka gjykuar çështje ku si palë është paraqitur "{\*\*\*}" ShA, shoqëri në të cilën ajo dhe familjarët e saj kanë pasur aksione në vlera të vogla, vlerëson se znj. Alkelina Gazidedja ka kryer shkelje që lidhen me etikën e magjistratit në punë, që nuk e bëjnë atë të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e saj si magjistrat, por që në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, dy vendimet e mësipërme duhet të përcillen pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore nga pikëpamja e etikës në punë.

**23.2** Gjatë hetimit administrativ dhe nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi se Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë aksione në shoqërinë "{\*\*\*}" ShA, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues i trupit gjykues në dy gjykime me palë shoqërinë "{\*\*\*}" ShA, dhe konkretisht:

**23.2.1 Çështja e parë:** Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen me palë paditëse shoqërinë "{\*\*\*}" ShA, me palë të paditur {\*\*\*} dhe objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhër ekzekutimit nr. {\*\*\*} prot., të nxjerrë nga {\*\*\*} më datë 20.01.2011 për kalimin në llogarinë e të ardhurave të {\*\*\*} të shumës prej 1.500.000 lekësh nga subjekti juridik {\*\*\*} [...]”, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 09.09.2014, ka vendosur pranimin e padisë së paraqitur nga shoqëria “{\*\*\*}”. Pala e paditur {\*\*\*} ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, çështje e cila është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 29.09.2016, kjo gjykatë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim, me arsyetimin se kjo gjykatë duhej fillimisht të merrte në shqyrtim nëse aktet objekt padie ishin kompetencë funksionale e gjykatës administrative.

**23.2.2 Çështja e dytë:** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen me palë paditëse shoqërinë "{\*\*\*}" ShA dhe palë të paditur {\*\*\*}, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.10.2013, ka vendosur pushimin e gjykimit për shkak të mosparaqitjes pa ndonjë shkak të arsyeshëm të palës paditëse, shoqërisë “{\*\*\*}”. Kjo e fundit ka bërë ankim të veçantë, çështje e cila është gjykuar në Gjykatën Administrative të Apelit, pjesë e trupës të së cilës ka qenë subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kryesuesit të çështjes. Në datën 18.02.2016, me vendimin nr. {\*\*\*}, kjo gjykatë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si vendim i drejtë dhe rrjedhojë e analizës së drejtë të provave dhe ligjit.

**23.3** Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.01.2019, konfirmon se subjekti i rivlerësimit figuron të ketë qenë aksioner i shoqërisë "{\*\*\*}" ShA, ku zotëronte 50 aksione, por me aplikimin e datës 11.09.2017, është larguar, pasi në këtë aplikim është depozituar Ekstrakti i Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve, datë 31.08.2017, në të cilin tashmë pasqyrohet aksioner i kësaj shoqërie z. D. D. G. (i biri i subjektit të rivlerësimit).

**23.4** Komisioni, nisur nga të dhënat e mësipërme, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përgjigje të së cilës është përgjigjur se: *[...] deklaroj se as unë, as familjarët e mi nuk kemi përfutur të ardhura nga kjo shoqëri, pasi asnjëherë prej saj nuk është shpërndarë dividendi, këtë fakt e ka konstatuar edhe Komisioni në rezultatet e hetimit [...].*

**23.5** Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e paraqitura në seancën publike të datës 28.10.2021, ka argumentuar se në Parimet e Bangalores për sjelljen e gjyqtarit, parashikohet se pronësia e thjeshtë e një për qind (1%) ose më pak të aksioneve në një korporatë publike zakonisht konsiderohet të jetë një interes *de minimis*, që nuk kërkon përjashtimin e një gjyqtari në një çështje që përfshin atë korporatë.

**23.6** Duke iu referuar nenit 3, pika 1 e ligjit 9367 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” parashikohet: *“Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të*

*drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.*

Në nenin 72, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile parashikohet se gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi një çështjeje konkrete kur ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim. Gjithashtu në vendimin nr. 16, datë 11.11.2004, Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, ka arsyetuar: [...] *Në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve zyrtare, personi i zgjedhur apo nëpunësi publik nuk duhet të ndikohet nga interesat e ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizikë dhe juridikë, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike [...].*

**23.7** Kolegji vëren se në Komentarin e Parimeve të Bangalores, në pikën 52 të saj parashikohet se: *Paanshmëria është cilësia themelore e kërkuar nga një gjyqtar dhe atributi kryesor i gjyqësorit. Paanshmëria duhet të ekzistojë edhe si çështje faktike, edhe si çështje e perceptimit të arsyeshëm. Nëse njëanshmëria perceptohet në mënyrë të arsyeshme, ky perceptim ka të ngjarë të lërë një ndjenjë ankese dhe padrejtësie që është kryer, duke shkatërruar kështu besimin në sistemin gjyqësor. Perceptimi i paanshmërisë matet me standardin e një vëzhguesi të arsyeshëm. Perceptimi se një gjyqtar nuk është i paanshëm mund të lindë në një numër mënyrash, për shembull, nga një konflikt interesi i perceptuar, nga sjellja e gjyqtarit në gjykatë, ose nga lidhjet dhe aktivitetet e tij jashtë gjyqësore [...]. Po në këtë dokument, në pikën 68, “Detyra për të zvogëluar konfliktet e interesit që rrjedhin nga aktiviteti financiar”, parashikohet: *Në mënyrë të ngjashme, një gjyqtar nuk duhet të lejojë që aktivitetet e tij financiare të ndërhyjnë në detyrën për të kryesuar çështjet që vijnë para gjykatës. Megjithëse disa përjashtime do të jenë të pashmangshme, një gjyqtar duhet të reduktojë konfliktet e panevojshme të interesit që lindin kur gjyqtari ruan interesa financiare në organizata dhe subjekte të tjera që paraqiten rregullisht në gjykatë, duke hequr dorë nga këto interesa. Për shembull, aksionet në pronësi të një gjyqtari mund të jenë të një rëndësie të tillë për të, pavarësisht nga vlera e tij de minimis kur shihet në dritën e madhësisë së korporatës, ai përjashtim është i garantuar. Po kështu, gjyqtari duhet të jetë i vetëdijshëm që publiku mund ta shohë pronësinë e aksioneve si një interes skualifikues. Sidoqoftë, gjykatësi nuk duhet të përdorë aksione de minimis padyshim si një mjet për të shmangur gjykimin e çështjeve.**

**23.8** Si rrjedhojë e sa më sipër, duke ditur parimin se subjekti i rivlerësimit përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizikë dhe juridikë, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike, në rastin konkret, duket sikur ka konflikt interesi, por nga ana tjetër, sipas parashikimeve në Komentarin e Parimeve të Bangalores, rrethanave faktike në të cilat ndodhet subjekti i rivlerësimit lidhur me aksionet që disponon në masën 0,0003% në {\*\*\*}, konsiderohet të jetë një interes *de minimis* që nuk kërkon përjashtimin e një gjyqtari në një çështje që përfshin atë korporatë pronësie e thjeshtë deri në 1%. Gjithashtu, sipas këtij parashikimi të Komentarit, gjyqtari nuk duhet ta shohë pronësinë si një interes skualifikues për të shmangur gjykimin e çështjeve, pasi interesi konsiderohet aq minimalist, saqë nuk mund të ketë ndikim në paanësinë e gjyqtarit në gjykimin e çështjes.

**23.9** Në përfundim të shkakut të ankimit lidhur me këto çështje, rezultoi se shqyrtimi nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, i dy çështjeve gjyqësore të finalizuara përkatësisht me vendimet nr. {\*\*\*}, datë 29.09.2016 dhe nr. {\*\*\*}, datë 18.02.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit, me palë paditëse shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj kanë zotëruar aksione pranë kësaj shoqërie, rezultoi se subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e konfliktit të interesit sipas nenit 72, pika 1 dhe nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, por kjo shkelje nuk ka qenë në një nivel të tillë që mund të kualifikonte rastin sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pikërisht duke konsideruar edhe parashikimet në Komentarin e Bangalores cituar në paragrafët më sipër, si dhe parë kjo edhe në funksion të përfundimit me vendim të këtyre çështjeve, në të cilat pala ndërgjyqëse, shoqëria “{\*\*\*}” ShA, nuk ka rezultuar gjyqfituese. *Sa më sipër, shkak i ankimit i ngritur nga Komisioneri Publik nuk gjendet i bazuar.*

- 24.** Në vijim të denoncimit anonim të protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.01.2020, në të cilin pretendohet se subjekti i rivlerësimit kishte gjykuar të njëjtën çështje si në shkallë të parë, ashtu edhe në apel, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me detyrimin kushtetues për gjykimin e paanshëm nga gjykatat, duke qenë anëtar i trupës gjykuese në dy shkallë të ndryshme gjykimi, për të njëjtin objekt dhe palë, duke mos respektuar në këtë mënyrë parimin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor, të parashikuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Vendimmarrja e Komisionit për transferimin e kësaj çështjeje organit inspektues, është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

**24.1** Konkluzionet e Komisionit për çështjen e parë ({\*\*\*}): [...] *Komisioni konkludon se trupi gjykues i Gjykatës Administrative të Apelit, në përbërje të të cilit ishte subjekti i rivlerësimit, ka gjykuar një vendim të shpallur nga një gjyqtar tjetër, i ndryshëm nga subjekti. Nisur nga fakti se: (i) vendimi i shpallur nga subjekti si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk ishte pjesë e fashikullit në gjykimin administrativ të apelit; (ii) nga koha e gjatë që nga gjykimi i parë në vitin 2009 e deri në gjykimin në apel në vitin 2014; (iii) në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është gjykuar në themel çështja, por vetëm për anën formale të padisë; (iv) subjekti ishte anëtar i trupit gjykues dhe jo relator i çështjes, Komisioni vlerëson se subjekti ka pasur mundësi të ishte në kushtet e padijes se kishte gjykuar më parë çështjen me palë “{\*\*\*}” ShPK. Bazuar në rrethanat e mësipërme, duke marrë në konsideratë edhe vendimin nr. 7, datë 11.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni çmon se nuk jemi përpara shkeljeve që e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin si magjistrat, por që në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ky vendim duhet të përcillet pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.*

**24.2** Gjatë hetimit administrativ, Komisionit i rezultoi se në lidhje me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.07.2016, të Gjykatës së Lartë, me paditës shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe të paditur {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë padinë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, duke pranuar pjesërisht padinë me vendim nr. {\*\*\*}, datë 14.09.2009, sipas të cilit është anuluar pjesërisht akti administrativ, duke reduktuar gjobën e parashikuar në të, nga 1.000.000 lekë në

500.000 lekë. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe është rikthyer për rigjykim me një tjetër trup gjykues në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka pushuar çështjen me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 05.12.2011, për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 05.07.2012. Në datën 17.07.2012, pala paditëse "{\*\*\*}" e ka ngritur sërish padinë, duke kërkuar edhe rivendosjen në afat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 02.11.2012, ka pranuar kërkesën. Në datën 16.11.2012, paditësi ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, padinë për kundërshtimin e aktit administrativ, në përfundim të të cilit gjykata, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.06.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim paditësi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 02.04.2014, ka vendosur mospranimin e ankimit të shoqërisë "{\*\*\*}" ShPK, sepse nuk plotëson kushtet ligjore të pranueshmërisë për shqyrtim, pasi ankimi nuk përmban vulën e shoqërisë. Në këtë gjykim, subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues. Kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 02.04.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë shoqëria "{\*\*\*}" ShPK.

**24.3** Komisioni, në lidhje me dokumentacionin e administruar për shkak të denoncimit, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në vendimmarrjen për të njëjtën çështje, me palë dhe objekt të njëjtë si në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, ashtu dhe në Gjykatën e Apelit Administrativ. Për sa më sipër, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur kushtet objektive dhe subjektive të parimit të paanësisë duke mos respektuar në këtë mënyrë parimin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor, të parashikuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye i kaloi barrën e provës subjektivit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën. Subjekti i rivlerësimit në përgjigjen e datës 20.01.2020 të rezultateve të hetimit shtesë, ka cituar: [...] *Në gjykimin e kryer në Dhomën e Këshillimit në Gjykatën e Apelit Administrativ, nuk është relatuar fakti që unë e kam shqyrtuar më parë këtë çështje, pasi në dosjen gjyqësore objekt gjykimi nuk është administruar asnjë lloj dokumenti shkresor, i cili të provonte faktin se unë kam gjykuar këtë çështje në një shkallë tjetër gjykimi. Gjithashtu, asnjëra nga palët ndërgjyqëse në këtë gjykim, nuk e ka ngritur ndonjëherë këtë çështje, edhe pse duhet të ishin në dijeni të këtij fakti, për shkak se kishin qenë pjesëmarrëse në gjykimin e parë të kryer me të njëjtat palë ndërgjyqëse dhe të njëjtin objekt. [...] Kam qenë anëtare e trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit, e cila ka vendosur apo shqyrtuar mbi një vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë, në të cilën nuk kam qenë gjyqtare.*

**24.4** Gjykata e Lartë, e cila ka shqyrtuar rekursin e ngritur nga paditësi "{\*\*\*}" në vendimin e saj nr. {\*\*\*}, datë 06.07.2016, ka vendosur prishjen e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 02.04.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, për arsye se nga studimi i dosjes, ka rezultuar se një nga anëtarët e kolegjit pranë Gjykatës Administrative të Apelit (gjyqtarja Alkelina Gazidede) ka marrë pjesë në vendimmarrjen objekt rekursi, në një kohë që po kjo gjyqtare, për të njëjtën çështje, me palë dhe objekt të njëjtë, ka dhënë vendim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar pjesërisht

padinë e paditësit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në vendim ka vlerësuar se procesi i rregullt ligjor i parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së, si dhe nga nenet 41, 42 të Kushtetutës, si një element të rëndësishëm dhe të qenësishëm ka pavarësinë dhe paanësinë e gjykatës e cila shqyrton konfliktin. Jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese ka pranuar si detyrim kushtetues gjykimin e paanshëm nga gjykatat. Më tej, Gjykata e Lartë në vendim ka arsyetuar se nuk është respektuar ky parim i rëndësishëm kushtetues dhe vlerësimi për respektimin e parimit të paanësisë bëhet sipas rastit, duke marrë në konsideratë elementet subjektive dhe objektive të gjykimit. Në këtë kontekst, gjykata konkludoi që anëtarja e trupit gjykues Alkelina Gazidede nuk i përmbush kushtet objektive dhe subjektive të parimit të paanësisë.

**24.5** Kolegji vëren se në vendimin e Gjykatës Kushtetuese me nr. 21, datë 29.04.2010, citohet se: *Për Gjykatën, është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili, në këndvështrimin objektiv, nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Duke u bazuar gjithashtu në rezolutën me 10 parimet bazë të miratuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, lidhur me parimin e paanësisë shprehet: Gjyqtarët duhet që të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme duke e garantuar dhe evidentuar paanshmërinë. Ata duhet të kujdesen që të shmangin në çdo rast konfliktin e interesit, por edhe përzierjen në të gjitha ato situata të cilat perceptohet se e përfshijnë apo krijojnë për gjyqtarët konflikt interesit. Lidhur me paanshmërinë, gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri të plotë, si dhe të garantojnë aparcencën e paanshmërisë.*

**24.6** Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, prapësoi në parashtrimet e paraqitura në seancë publike në Kolegji se: *Gjatë relativitetit të kryer për këtë çështje, nuk është evidentuar asnjë e dhënë apo shkak i arsyeshëm në mënyrë që unë si anëtare e trupit gjykues, të kisha dyshime për të verifikuar përmbajtjen e akteve të administruara në dosjen gjyqësore, pasi vetëm në këtë rast, unë, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, mund të kërkoj që të vlerësoj apo të hetoj përmbajtjen e provave (akteve dokumentare të administruara në dosjen gjyqësore). Nuk rezulton që pala paditëse të ketë sjellë parashtrime në lidhje me këtë çështje, në mënyrë që trupi gjykues të merrte në vlerësim pretendimin e palës paditëse në proces, të ngritur vetëm pas dhënies së vendimit në rekursin e bërë prej saj, se unë kisha dhënë vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.09.2009. [...] Gjithashtu, asnjëra nga palët ndërgjyqëse në këtë gjykim, nuk e ka ngritur ndonjëherë këtë çështje, edhe pse ato duhet të ishin në dijeni të këtij fakti, për shkak se kishin qenë pjesëmarrëse në gjykimin e parë të kryer me të njëjtat palë ndërgjyqëse dhe të njëjtin objekt. Referuar fletëthirrjeve të datës 15.03.2014, palët ndërgjyqëse janë njoftuar për ditën dhe orën e gjykimit në dhomë këshillimi duke ju prezantuar edhe përbëja e trupit gjykues. Paditësi konkretisht ka marrë dijeni që në datë 27.03.2014, që në përbërje të këtij trupi gjykues isha edhe unë, dhe deri në datë 02.04.2014 nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin tim. Edhe nga hetimi që ka kryer Komisioni sipas shkresës kthim përgjigje të kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. {\*\*\*}, datë 30.01.2020, nuk rezulton që pjesë e kësaj dosjeje të ketë qenë nëndosja nr. {\*\*\*}, datë 14.09.2009.*

**24.7** Pas verifikimit të argumenteve të sjella nëpërmjet parashtrimeve nga subjekti i rivlerësimit, Kolegji konstatoi se në dosjen e Komisionit rezulton se shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 28.01.2020,

e Komisionit, me lëndë “Kërkesë informacioni”, i është dërguar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, nëpërmjet së cilës i kërkohet kësaj gjykate se cila është arsyeja që dosja nr. {\*\*\*}, vendimi datë 14.09.2009, nuk është pjesë e dokumentacionit të dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit në Komision me kërkesë të këtij të fundit. Në përgjigjen me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.01.2020, Gjykata Administrative e Apelit ka sqaruar se në inventarin e dosjes me nr. {\*\*\*} vendimi, datë 28.06.2013 (vendimi i ankuar në Gjykatën Administrative të Apelit) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka shënim se bashkëlidhur dosjeve, është edhe dosja me nr. {\*\*\*} vendimi, datë 14.09.2009. Nuk rezulton që ky fashikull të jetë përcjellë me dosjen gjyqësore që ka ardhur në Gjykatën Administrative të Apelit bazuar në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.02.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Nga ky verifikim, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk e kishte pasur në dispozicion dosjen që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 14.09.2009, për të kuptuar në këtë mënyrë që ka gjykuar një padi me të njëjtat palë. Rezultoi e provuar se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka marrë fare në shqyrtim çështjen që lidhet me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.06.2013, të Gjykatës së Shkallës së Parë, pasi për shkak të të metave procedurale të ankimit, Gjykata Administrative e Apelit vendosi mospranimin e tij. Në mungesë të zhvillimit të gjykimit në prani të palëve, në mungesë të debatit mbi themelin e çështjes, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë ardhur në dijeni të këtij fakti, i cili nuk i është bërë me dije as nga palët, por eventualisht, nisur nga periudha kohore prej afro 5 vitesh nga çështja në çështje (2010-2014), e bën të besueshëm faktin e harresës për shkak të kohës së gjatë të kaluar dhe ngarkesës në punë. Si rrjedhojë, në këto kushte, nuk rezultoi e provuar dijenia e subjektit të rivlerësimit sa i përket gjykimit të së njëjtës çështje në dy shkallë të ndryshme gjykimi, ndaj nuk kemi shkelje të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, si dhe nuk u provua që nuk është garantuar rendi i së drejtës dhe nuk u janë dhënë palëve garancitë e nevojshme objektive për të krijuar besim në paanshmërinë e gjykatës. *Si rrjedhojë, shkak i ankimit i ngritur nga Komisioneri Publik, nuk gjendet i bazuar.*

**24.8** Lidhur me çështjen e dytë të pretenduar në denoncim (sipas shkakut të ankimit në paragrafin 24), Komisioni ka arritur në këto konkluzione: *[...] konstatohet se subjekti nuk ka dhënë këshilla apo nuk ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim, si dhe nuk ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në themel. Në këto kushte, çmohet se sjellja e subjektit nuk përfshihet në rastet për përjashtimin e gjyqtarit, sipas parashikimeve të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Pasi analizoi kushtet dhe rrethanat, veprimet e subjektit, si dhe pasojat e ardhura, Komisioni çmon se nuk jemi përpara shkeljeve që e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e saj si magjistrat, por që në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, ky vendim duhet të përcillet pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.*

**24.9** Gjatë hetimit administrativ, Komisionit i rezultoi se në lidhje me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.12.2016, të Gjykatës së Lartë, me paditës i kundërpaditur {\*\*\*} dhe të paditur kundërpaditës P. D. e të tjerë, subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, anëtare e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, ka shqyrtuar të njëjtën kërkesëpadi edhe kur ka qenë gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

**24.10** Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se gjyqtarja anëtare e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, është caktuar me short për të gjykuar këtë kërkesëpadi kur ka qenë pjesë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Nga subjekti i rivlerësimit, në datën 19.03.2010, është marrë vendimi për caktimin e seancës përgatitore në datën 14.04.2010, në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë. Në datën 14.04.2010, është kryer seanca përgatitore dhe seanca e ardhshme është caktuar për në datën 13.05.2010. Rezulton se më pas, duke filluar nga data 19.04.2010, subjekti i rivlerësimit është transferuar në seksionin penal dhe, për rrjedhojë, çështja është rihedhur përsëri në short. Në Gjykatën Administrative të Apelit, në përbërje të trupit gjykues të së cilës, me cilësinë e anëtares ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.02.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e padisë së paditësit {\*\*\*}. Kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 04.02.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs, pala e paditur kundërpaditëse e cila kërkon prishjen e vendimit të gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke parashtruar, ndër të tjera, edhe faktin se gjyqtarja anëtare e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit ka shqyrtuar këtë kërkesëpadi edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**24.11** Lidhur me konstatimet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e asaj çka ka rezultuar në rezultatet e hetimit. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të këtyre rezultateve, ka sqaruar se: *Pavarësisht arsyetimit të dhënë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, parashtroj se pjesëmarrja ime në shqyrtimin e kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, nuk ka qenë e papajtueshme me asnjë nga rastet që ka parashikuar ligjvënësi në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile dhe se veprimet e mia të kryera mbi këtë çështje, nuk kanë asnjë impakt, shprehje qëndrimi apo sikundër përpiqet të arsyetojë Gjykata e Lartë [...]. Nga data 19.04.2010, jam transferuar si gjyqtare në seksionin penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, për rrjedhojë, me këtë dosje nuk është kryer më asnjë lloj veprimi procedural nga ana ime si gjyqtare [...]. Theksoj se, në fazën e gjykimit që e kam marrë në shqyrtim këtë çështje, unë nuk kam dhënë asnjë lloj mendimi për themelin e gjykimit, në mënyrë që të konsiderohesha si e papajtueshme për të marrë pjesë për gjykimin e saj në një shkallë apo fazë tjetër gjykimi, parashikuar nga neni 72, pika 4 e Kodit të Procedurës Civile [...].*

**24.12** Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se Gjykata e Lartë (Kolegji Administrativ) në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.12.2016, në lidhje me sa më sipër, është shprehur se: *Nisur nga përmbajtja e dispozitave të sipërcituara dhe nga tërësia e veprimeve aktive që kryen gjyqtari gjatë seancës përgatitore, Kolegji Administrativ konstaton se qenia anëtare e trupës gjyqësore e gjyqtares Alkelina Gazidede në këtë shkallë gjykimi, nuk ka qenë e papërfullshme ndaj dhe dyshimi i palës së paditur është i bazuar nga ana objektive [...].*

**24.13** Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në Gjykatën e Lartë [shih vendimin nr. 4, datë 25.02.2009, të Gjykatës Kushtetuese]. Për gjykatën, është konsideruar



“gjykatë e anshme”, trupi gjykues në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili në këndvështrimin objektiv, nuk jep garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrim se: *[...] thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje* [shih vendimin nr. 48, datë 30.07.1999, të Gjykatës Kushtetuese].

**24.14** Kolegji sjell në vëmendje një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor apo të procesit të drejtë, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është paanshmëria e gjykatës në gjykimin e çështjes. Në këtë kuadër, parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimin nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe duhet të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë [shih vendimin nr. 12, datë 13.04.2007, të Gjykatës Kushtetuese).

**24.15** Nisur nga përmbajtja e dispozitave të sipërcituara dhe nga tërësia e veprimeve aktive që kryen gjyqtari gjatë seancës përgatitore, konstatohet se qenia anëtare e trupës gjyqësore e subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, në këtë shkallë gjykimi, nuk ka qenë e papërfillshme ndaj dhe dyshimi i palës së paditur ishte i bazuar nga ana objektive, pasi ka krijuar një dyshim të justifikuar tek ai se vendimi i dhënë ka qenë produkt i një procesi të dyshuar si të njëanshëm. Në lidhje me këtë rrethanë faktike, konstatohet se Gjykata e Lartë (Kolegji Administrativ), në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.12.2016, është shprehur për shkak të rekursit të z. P. D., për shkaqe të ngritura pas dhënies së vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, si rrjedhojë në vlerësimin e Kolegjit, subjekti i rivlerësimit nuk e dinte dhe as nuk kishte mundësi ta dinte se po cenonte parimin e paanshmërisë së pretenduar nga rekursuesi.

**24.16** Në parashtrimet e dorëzuara, subjekti i rivlerësimit në seancë publike në Kolegj, lidhur me këtë shkak ankimi, ka argumentuar se: *[...] referuar të dhënave që janë të administruara në këtë dosje gjyqësore, ka rezultuar e provuar se kjo çështje është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 17.03.2010 dhe është caktuar me short për t’u shqyrtuar nga ana ime, si gjyqtare relatores. Në datën 14.04.2010, është kryer seanca përgatitore dhe seanca gjyqësore është caktuar për në datën 13.05.2010. Nga data 19.04.2010, jam transferuar si gjyqtare në seksionin penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, për rrjedhojë, me këtë dosje nuk është kryer më asnjë lloj veprimi procedural nga ana ime si gjyqtare. Kjo çështje është rishortuar dhe një gjyqtar tjetër ka shqyrtuar dhe vendosur mbi këtë çështje. Theksoj se, në fazën e gjykimit që e kam marrë*

*në shqyrtim këtë çështje, unë nuk kam dhënë asnjë lloj mendimi për themelin e gjykimit, në mënyrë që të konsiderohesha si e papajtueshme për të marrë pjesë për gjykimin e saj në një shkallë apo fazë tjetër gjykimi, parashikuar nga neni 72, pika 4 e K.Pr.Civile se çfarë veprimesh kam kryer unë si gjyqtar i vetëm, pasqyrohet qartësisht në aktet e administruara në dosje dhe konkretisht në procesverbalin e seancës përgatitore, datë 14.04.2010.*

**24.17** Kolegji vëren se, pas verifikimit të dokumentacionit që gjendet në dosjen e Komisionit, rezulton, ndër të tjera, se subjekti i rivlerësimit ka caktuar datën për seancën përgatitore më datë 14.04.2010. Në veprimet përgatitore të kësaj seance, subjekti i rivlerësimit ka verifikuar prezencën e palëve, si dhe ka pranuar kërkesën e paditësit {\*\*\*} për shtyrjen e seancës gjyqësore në datën 13.05.2010. Pjesë e kësaj dosjeje është edhe shënimi i subjektit të rivlerësimit, i cili daton më 29.04.2010, sipas të cilit është shprehur se më datë 19.04.2010, i është komunikuar se në bazë të urdhrin të kryetarit të gjykatës, është caktuar të gjykojë në seksionin penal, jo në atë administrativ ku gjykonte deri në atë datë. Sipas këtij komunikimi, ka sqaruar se çështja me nr. {\*\*\*} akti (çështja objekt shqyrtimi), do të rihidhet në short për t'iu caktuar një gjyqtari tjetër. Këto janë veprimet e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje. Siç shihet, subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e gjyqtarit të vetëm, nuk ka dhënë asnjë lloj mendimi në lidhje me themelin e kësaj çështjeje, por ka thirrur palët duke verifikuar aktet e përfaqësimit, duke legjitimuar përfaqësuesit ligjorë të palëve, dhe më pas ka shtyrë seancën, duke u dhënë mundësi palëve që të japin shpjegimet dhe provat përkatëse për çështjen. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë lloj mendimi/vendimi në lidhje me zgjidhjen e kësaj çështjeje, si dhe me rrethanat dhe themelin e saj, pasi në këtë fazë nuk kishte filluar akoma shqyrtimi gjyqësor. Pala që ka ushtruar të drejtën e rekursit, ka qenë tërësisht në dijeni të pjesëmarrjes së subjektit si anëtar i trupit gjykues në gjykimin e kësaj çështjeje pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, pasi ka pasur dijeni për trupin gjykues që do të shqyrtonte çështjen në dhomë këshillimi nëpërmjet fletëthirrjes përkatëse. Referuar akteve të administruara në dosje, pala ka marrë dijeni për trupën gjyqësore, pasi ka nënshkruar rregullisht fletëthirrjen, por në asnjë nga aktet e administruara në dosje, nuk ka rezultuar që të ketë kërkuar përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga trupa gjyqësore, duke reklamuar një gjë të tillë vetëm në rekurs.

**24.18** Sa më sipër, nuk identifikohet se në cilin prej rasteve të papajtueshmërisë së parashikuar nga neni 72 i K.Pr.Civile ndodhet subjekti i rivlerësimit, pasi pika 4 e këtij neni parashikon një ndër rastet kur gjyqtari ka gjykuar një çështje në një shkallë tjetër gjykimi, por gjykimin nga subjekti i rivlerësimit në këtë gjykatë (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë) nuk ka ndodhur për arsyet e cituara më sipër të transferimit të subjektit të rivlerësimit në një tjetër seksion gjykimi e, si rrjedhojë, subjekti nuk ndodhet para këtij rasti. Nuk rezulton të provohet as dhënia e këshillave apo shfaqja e ndonjë mendimi të mëparshëm në kohë, qenia dëshmitar, ekspert apo përfaqësues i njëjës palë në çështjen që ka gjykuar subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, shkaku i ngritur nga Komisioneri Publik, nuk gjendet i bazuar.

- 25.** Lidhur me shkakun e ankimit për denoncimin nr. {\*\*\*}, datë 24.04.2019, të denoncuesit Q. V., i cili ankohet se trupi gjykues ku në përbërje të të cilit ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit, është

mbështetur në një vendim gjykate, i cili rezulton të jetë prishur nga gjykata më e lartë, Komisioneri Publik pretendon se shkelja e konstatuar është e karakterit procedural dhe duhet marrë parasysh në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**25.1** Konkluzionet e Komisionit për këtë çështje: *Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk justifikojnë faktin se, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, ka marrë një vendim mbështetur në një vendim të një gjykate, i cili rezulton të jetë i prishur nga gjykata më e lartë. Është e vërtetë që relatori i çështjes ka për detyrim të relatojë faktet dhe rrethanat, por çdo anëtar ka të drejtë të shohë provat, si dhe të konsultohet me dokumentacionin e dosjes. Komisioni vlerëson se, nga subjekti, nuk është vepruar drejt në këtë rast, pavarësisht justifikimit me pozicionin në trupin gjykues si anëtare dhe jo relatores, si dhe ngarkesës ditore, por këto veprime nuk janë të një përmase të tillë, që përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit.*

**25.2** Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, rezultoi se në datën 19.11.2015, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. {\*\*\*}, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e padisë. Në pjesën arsyetuese, kjo gjykatë është shprehur se: *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 09.12.1998, ka vendosur pavlefshmërinë e kontratës së shitjes [...]. Në kushtet kur titulli i pronësisë i paraqitur nga paditësi Q. V. është shpallur i pavlefshëm me vendim gjyqësor, atëherë arrihet në përfundim se kjo kontratë nuk përbën titull pronësie [...]. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se vendimi nr. {\*\*\*}, datë 09.12.1998, është prishur më datë 26.04.1999, me vendimin nr. {\*\*\*} të Gjykatës së Apelit Vlorë, duke vendosur dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Në datën 15.09.1999, me vendimin nr. {\*\*\*}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pushimin e çështjes së mësipërme me kërkesën e paditësit.*

**25.3** Nga dokumentacioni dhe rrethanat e cituara më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në dhënien e vendimit, është mbështetur në një vendim që gjykata e kishte prishur, si dhe nuk ka konstatuar nëse vendimi nr. {\*\*\*} kishte marrë formë të prerë, ndaj për këtë fakt i kaloi subjektit barrën e provës, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit të datës 10.12.2019, u përgjigj se: *Në lidhje me këtë konstatim, shprehem se në këtë çështje kam qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues. Referuar vendimit, rezulton se palët në ankim kundërshtojnë vendimin e shkallës së parë pikërisht për ekzistencën e këtij vendimi. Në marrjen e vendimit, jemi bazuar në aktet e ndodhura në dosje. Por referuar denoncimit të bërë nga ky shtetas, i cili shprehet se në faqen 111 të dosjes është ky vendim të cilin ne nuk e kemi parë, kam kërkuar ta verifikoj dosjen. Kam kërkuar të shoh dosjen, por deri në ditën e sotme ka qenë objektivisht e pamundur. Rezervoj të drejtën që, pasi të njihem me dosjen, të jap mendim në lidhje me këtë konstatim të Komisionit.*

**25.4** Me dorëzimin e prapësimeve, pas rezultateve të hetimit shtesë, lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 20.06.2020, është shprehur se: *Referuar natyrës së gjykimit, në dhomë këshillimi, proceduralisht shqyrtimi i dosjes dhe përmbledhja e relacionit përkatës është detyrë funksionale e gjyqtarit relator. Në relacionin e hartuar nga gjyqtari relator, si dhe nga parashtrimet e fakteve të bëra prej tij në dhomë këshillimi, është evidentuar se vendimi*

nr. {\*\*\*}, datë 09.12.1998, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendim gjyqësor i formës së prerë. Gjatë relativitetit të kryer nuk është evidentuar asnjë e dhënë apo shkak i arsyeshëm në mënyrë që unë, si anëtare e trupit gjykues, të kisha dyshime për të verifikuar përmbajtjen e akteve të administruara në dosjen gjyqësore. Në këtë kuptim, unë, si anëtare e trupit gjykues, nuk mund të penalizohem dhe të mbaj përgjegjësi për çështje, të cilat nuk i takojnë anëtarit të trupit gjykues, por gjyqtarit relator, të përcaktuar me short për studimin, shqyrtimin dhe relativitetin e tij para trupës gjyqësore, e cila merr vendimin përfundimtar.

**25.5** Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, ka argumentuar në parashtrimet në seancë publike në Kolegj se: Unë, si anëtare e trupit gjykues, nuk mund të penalizohem dhe të mbaj përgjegjësi për çështje të cilat nuk i takojnë anëtarit të trupit gjykues, por gjyqtarit relator të përcaktuar me short për studimin, shqyrtimin dhe relativitetin e tij para trupës gjyqësore, e cila jep vendimin përfundimtar. Vlen të theksohet se ligjvënësi jo pa qëllim ka përcaktuar rolin dhe funksionet gjyqtarit relator, të cilat janë krejtësisht të ndryshme nga roli dhe funksionet që kanë gjyqtarët anëtarë të trupit gjykues, sidomos kur gjykimi kryhet në dhomë këshillimi. Duhet kuptuar se trupa gjyqësore, kur gjykon në dhomë këshillimi, në ndryshim nga gjykimi që kryhet në seancë gjyqësore, gjykon mbi bazën e të dhënave, fakteve dhe rrethanave që relatohen nga gjyqtari relator. Në rast se anëtarët e trupit gjykues, nuk kanë indicie të arsyeshme për të vënë në diskutim përmbajtjen e provave apo ekzistencën e tyre në dosjen gjyqësore, ato konsiderohen në mirëbesim dhe mund të diskutojnë për mënyrën e zgjidhjes së çështjes, duke u fokusuar vetëm te qëndrimi i tyre në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Në këtë çështje, pala nuk ka pretenduar se është zbatuar keq ligji, por ka pretenduar se nuk ka vlerësuar drejt përmbajtjen e provës. Për këtë arsye, në kushtet kur unë kam qenë anëtare e trupit gjykues, e cila e ka gjykuar këtë çështje në dhomë këshillimi, nuk mbaj asnjë përgjegjësi ligjore dhe procedurale, pasi nuk ka qenë detyra ime funksionale për të bërë shqyrtimin e dosjes dhe të verifikoj përmbajtjen e provës, kur nuk ekzistonte asnjë lloj indicieje për të ushtruar këtë veprim. Aktualisht kjo çështje është për gjykim në Gjykatën e Lartë. Në këto rrethana, referuar pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni konstaton se nuk i hyn shqyrtimit të çështjeve që janë ende në proces.

**25.6** Kolegji vëren se, pas verifikimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, çështja që i përket paditësit Q. V. (denoncuesi) dhe të paditurve H. V., Rr. Y., H. K., {\*\*\*}, rezulton se është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 23.06.2016 dhe është me status “studim i çështjes”. Gjithsesi, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës së kaluar nga Komisioni. Prapësimi i tij se ka qenë në këtë çështje në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues dhe nuk ka qenë i prezantuar me vendimin e formës së prerë nga relatori i çështjes, nuk është bindës dhe i bazuar. Gjyqtari, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, nuk mund të tregohet indiferent ndaj provave dhe dokumentacionit që gjendet në dosje, aq më tepër kur bëhet fjalë për vendim gjyqësor të vitit 1998 dhe vijueshmërinë e tij, të cilit minimalisht duhet t’i verifikohet statusi nëse ka një vendim tjetër që e lë në fuqi apo ka vendosur prishjen dhe kthimin për rigjykim. Mospërfshirja e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, në një masë të tillë sa nuk ka shqyrtuar as provat e

ndodhura në dosje, është në kundërshtim me nenin 72 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por pesha e kësaj shkeljeje nuk konsiderohet e tillë për t’u kualifikuar në nenin 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

26. Lidhur me shkakun e ankimit për denoncimin nr. {\*\*\*}, datë 08.04.2019, të denoncuesit P. P., i cili ankohet ndaj trupës gjyquese të Gjykatës Administrative të Apelit, duke pretenduar se nga ana e saj ka shkelje procedurale në dhënien e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 14.02.2018, ku subjekti i rivlerësimit rezulton se ka qenë anëtar i këtij trupi gjyqes, Komisioneri Publik pretendon se shkelja e konstatuar është e karakterit procedural dhe duhet marrë parasysh në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, Komisioneri Publik çmon se mangësitë dhe problematikat e konstatuara në mënyrë të përsëritur edhe nga Komisioni, në rastet e mësipërme, bazuar në një vlerësim objektiv mbi kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 96/2016, si dhe në një vlerësim tërësor bazuar në nenin 4, pika 2, duhet të çojnë në zbatimin e nenit 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

**26.1** Konkluzionet e Komisionit për këtë çështje: *Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se nuk justifikojnë faktin se gjykata është mbështetur në një vendim të Kolegjeve të Bashkuara, i cili rezulton të jetë i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Në vlerësim të fakteve, Komisioni mban në vëmendje pozitën e subjektit si anëtare e trupit gjyqes, si dhe ngarkesën e lartë në këtë gjykatë.*

**26.2** Kolegji vëren se, nga hetimi administrativ në Komision, rezultoi se, me dekretin e Presidentit të Republikës me nr. {\*\*\*}, datë 11.02.2015, prokurore A. P. transferohet nga detyra e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, në atë të prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat. Pas këtij momenti, prokurore A. P. i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me padi me objekt: Shfuqizimin e dekretit nr. {\*\*\*} të Presidentit të Republikës për transferimin e kësaj prokuroreje, si dhe kthimin e paditëses në detyrën e prokurores pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka pranuar padinë e znj. A. P., e cila përfaqësohej nga av. P. P. Ndërkohë, Gjykata Administrative e Apelit, ku në trupë gjyquese ka qenë subjekti i rivlerësimit, ka rrëzuar padinë me arsyetimin se: *Në interpretim të praktikës gjyqësore të unifikuar në vendimin nr. 03, datë 30.01.2003, të Kolegjeve të Bashkuara, i cili ka përcaktuar se nuk mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor ligjshmëria e dekretit të Presidentit në aspektin procedural, nuk legjitimohet si i paditur Presidenti i Republikës që ka nxjerrë dekretin, por Prokurori i Përgjithshëm. Dekretet e Presidentit janë akte të natyrës juridiko-kushtetuese [...].* Vendimi unifikues ku është mbështetur Gjykata Administrative e Apelit, rezulton të jetë shfuqizuar me vendimin nr. 38, datë 23.12.2003, të Gjykatës Kushtetuese.

**26.3** Lidhur me faktet e rezultuara më sipër, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës nëpërmjet rezultateve të hetimit administrativ, datë 19.11.2019, në përgjigje të të cilave subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e datës 10.12.2019, ka sqaruar se: *Në lidhje me këtë konstatim, sqaroj se në bazë të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se arsyetimi*

*i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër. Arsyetimi në rastin konkret është bërë nga kryetari i seancës. Për sa më sipër, unë nuk mund të mbaj përgjegjësi për mënyrën e parashtrimit të fakteve dhe arsyetimin e kryetarit të seancës, sigurisht që do të ishte ideale të lexoheshin edhe arsyetimet e kolegëve para se të firmosen, por kjo është e pamundur efektivisht me gjithë ngarkesën e madhe në punë.*

**26.4** Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj në seancën gjyqësore të datës 28.10.2021, argumentoi se: [...] Aktualisht kjo çështje është për gjykim në Gjykatën e Lartë. Në këto rrethana, referuar pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka ndalim të shqyrtojë çështje që janë ende në proces. [...] kundërshtoj ankimin e Komisionerit edhe në lidhje me këtë denoncim dhe çështje të gjykuara ku unë kam qenë në përbërje të trupit gjykues me cilësinë e anëtares, pasi vendimi të cilit referohet denoncuesi nuk ka qenë aspak objekt dhe shkak ligjor i vendimmarrjes sonë në çështjen objekt gjykimi. Në referim të rrethanave faktike dhe ligjore, rezulton se ne kemi vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe, në përfundim të gjykimit, kemi vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë. Në arsyetim është i vërtetë fakti se ka citim të vendimit të cilit i referohet në denoncim denoncuesi, por ky vendim, sikundër kam shpjeguar edhe përpara KPK, është vendosur në arsyetim të vendimit i cili, në bazë të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile, bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër. Arsyetimi, në rastin konkret, është bërë nga kryetari i seancës. Për sa më sipër, unë nuk mund të mbaj përgjegjësi për mënyrën e parashtrimit të fakteve dhe arsyetimin e kryetarit të seancës, sigurisht që do të ishte ideale që të lexoheshin edhe arsyetimet e kolegëve para se të firmosen, por kjo është e pamundur efektivisht me gjithë ngarkesën e madhe që kemi në punë.

**26.5** Pas verifikimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, çështja që i përket paditëses A. P. dhe të paditurve {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, rezulton se është regjistruar në Gjykatën e Lartë më datë 23.05.2018 dhe është me status “studim i çështjes”. Në këto rrethana, për sa kohë ndodhemi në kushtet e nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, kjo çështje pritet të gjykohet, me pretendimet dhe rrethanat e shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, të cilat janë në kompetencë të Gjykatës së Lartë. Gjithsesi, nga qëndrimet e subjektit të rivlerësimit gjatë seancave publike, vlerësohet se nënshkrimi i detyruar i vendimit sipas nenit 308, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, prezumon dakordësinë me arsyetimin e tij, ndërsa mosleximi i vendimit, siç pretendoi subjekti i rivlerësimit, pamundëson arsyetimin e tij, duke u kryer kështu vetëm nga kryesuesi i trupit gjykues. Sipas kësaj situate faktike, vendimi është firmosur vetëm për të përmbushur formalitetin nga subjekti i rivlerësimit dhe kjo është një praktikë e zakonshme siç e ka pranuar ai vetë. Në këtë mënyrë, në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit është dakordësuar me përmbajtjen dhe arsyetimin e vendimit pa e lexuar atë duke u mohuar palëve në proces gjykimin nga një trupë gjykuese, siç ishte gjykimi në rastin e denoncuar. Duke marrë parasysh kontekstin faktik të mësipërm, referimi në një vendim unifikues të shfuqizuar nuk mund të mos konsiderohet si një mangësi e subjektit të rivlerësimit, por kjo mangësi e tij nuk u konsiderua si e mjaftueshme për t’u klasifikuar sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

27. Komisioneri Publik ka renditur ndër shkaqet për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit edhe të dhënat nga raporti i vlerësimit profesional<sup>12</sup> të hartuar nga KLGj-ja, ku kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, si dhe nga inspektimi i Ministrisë së Drejtësisë në Gjykatën Administrative të Apelit ku subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me vonesa kohore në gjykim. Bazuar në gjetjet dhe mangësitë e konstatuara nga KLGj-ja, si dhe gjetjet e inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë, të konfirmuara këto edhe nga hetimi administrativ i Komisionit, në pamundësi të vlerësimit të dosjeve fizike objekt vlerësimi, Komisioneri Publik është ndalur në faktin e konstatuar të tejkalimit të afateve të gjykimit, si model i vërejtur në më shumë se një herë në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi ky fakt së bashku dhe me mangësitë e tjera, në këndvështrim të nenit E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, përbën cenim të së drejtës së qytetarëve për një gjykim brenda afateve të arsyeshme.

*27.1 Komisioni, në lidhje me sa më sipër, ka konkluduar se: [...] në lidhje me konstatimet e aktit të inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë, vlerëson që për të gjithë anëtarët e Gjykatës Administrative të Apelit janë konstatuar të njëjtat problematika, të cilat kanë ardhur si pasojë e ngarkesës së madhe në punë të kësaj gjykate, si dhe të mungesës së këshilltarëve dhe sekretareve gjyqësore. Për sa kohë këto konstatime janë evidentuar nga organet e tjera për efekt të vlerësimit etik dhe profesional, Komisioni e ka konsideruar të panevojshëm kërkimin e shpjegimeve të subjektit së bashku me rezultatet e hetimit.*

*27.2 Kolegji vëren se në raportin e KLGj-së lidhur me treguesit, aftësitë organizative, aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të kryer procedurat gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet, nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se katër nga pesë çështjet e vëzhguara janë gjykuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 48, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, ku parashikohet: “Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi”. Edhe pse këto çështje janë gjykuar në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh pa praninë e palëve, gjykimi ka zgjatur tej afateve ligjore. Nuk rezultoi që të ketë ndonjë seancë joproductive, ku shkak të jetë bërë mungesa e gjyqtarëve. Nga 5 dosjet e vëzhguara, vetëm 2 vendime janë arsyetuar brenda afatit 7-ditor të parashikuar nga neni 55, pika 3 e ligjit nr. 49/2012. Në një rast, vonesa ka tejkaluar edhe afatin e rekursit. Në raport është evidentuar fakti se subjekti i rivlerësimit ka pasur ngarkesë të lartë sasiore të çështjeve. Pavarësisht se për përfundimin e gjykimit të çështjeve brenda afatit ligjor (1 muaj) nuk varej gjithçka nga ajo, pasi planifikimi i seancës së parë gjyqësore bëhej nga kryetari i Gjykatës, me urdhër të të cilit sekretaria gjyqësore bën shpalljen e listës së gjykimeve, ajo nuk ka bërë përpjekjet e duhura për arsyetimin e vendimeve në respektim të afatit ligjor (7 ditë), të parashikuar nga neni 55/3 i ligjit nr. 49/2012.*

*27.3 Ministria e Drejtësisë ka inspektuar Gjykatën Administrative të Apelit për periudhën 15.12.2014 – 23.01.2015, me objekt inspektimi: “Verifikimi i zbatimit të dispozitave procedurale dhe administrative në gjykimin e çështjeve të regjistruara në këto gjykata”. Në përfundim të*

---

<sup>12</sup> Raporti i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. {\*\*\*}, datë 27.05.2019.

*inspektimit, është përgatitur një raport për të gjithë anëtarët e kësaj gjykate, ku për subjektin e rivlerësimit rezultojnë këto të dhëna: (i) ka dorëzuar jashtë afatit ligjor 400 vendime nga 513 në total, me një vonesë kohore 11 - 116 ditë, duke mos respektuar në këtë mënyrë dispozitat e nenit 55 të ligjit nr. 49/2012; (ii) i janë caktuar me short 1453 çështje administrative, nga të cilat ka përfunduar gjykimi dhe janë shpallur 530 vendime, duke qenë në proces 923 çështje, për të cilat rezulton se nuk është respektuar afati 30-ditor i parashikuar nga neni 48 i ligjit nr. 84/2012. Në lidhje me 530 çështjet e vendimuara, rezulton se 343 prej tyre janë shqyrtuar tej afatit 30-ditor, me një vonesë kohore nga 1 muaj mbi 5 muaj; (iii) subjekti i rivlerësimit ka caktuar data për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi 1-2 muaj nga data e regjistrimit të çështjes, duke tejkalluar afatin 30-ditor; (iv) periodiciteti i seancave gjyqësore në rastet kur gjykata ka vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore është shumë i madh, duke u bërë shkak për kohëzgjatjen e madhe të procesit. Shpeshherë, afati nga njëra seancë në tjetrën është mbi një muaj.*

**27.4** Subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi, në parashtrimet e dorëzuara në seancë publike në Kolegj, ka argumentuar se: *Sipas akteve në fuqi, një gjyqtar apeli, kriter i cili në mungesë të kriterit për gjykatën administrative të apelit do të gjejë zbatim për analogji sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 14.04.2010, duhet të gjykojë jo më pak se 200 çështje në vit. Viti ka 365 ditë, nga të cilat 36 janë pushime vjetore, 8 ditë në muaj janë pushim javor (8 dite x 12 muaj = 96 ditë), festat zyrtare 14 ditë, në total 146 ditë. Ngelen ditë pune, 219 ditë. Nga statistika e çështjeve të gjykuara për vitin 2014, unë kam përfunduar 593 çështje, B. H. 525 dhe R. S. 556. Pra, në total, si trup gjykues me përafërsi 1650 çështje. Për vitin 2015, unë kam përfunduar 470 çështje, gjyqtar A. M. 520 dhe gjyqtare L. S. 485, gjyqtare B. H. 350 çështje, në total përafërsisht 1800 çështje. [...]Nga statistikat, unë për vitin 2016 kam gjykuar të paktën 1300 çështje.*

**27.5** Kolegji sjell në vëmendje se parimi i zhvillimit të procesit brenda afateve të arsyeshme është një parim kushtetues, respektimi i të cilit mundëson realisht vënien në vend të të drejtave të personave. Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm rrjedh nga detyrimi i përcaktuar në nenin 42/2 të Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-së, si dhe nga neni 28 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi brenda afateve të arsyeshme lidhet edhe me kriterin e ekonomisë gjyqësore, pasi një proces i shpejtë dhe efektiv do të shmangte shpenzime gjyqësore të panevojshme për palët. Ky problem, mosrespektimi i afateve të arsyeshme, ka qenë dhe duket se vijon të jetë një nga problemet më të mëdha të proceseve gjyqësore në vend. Për këtë qëllim, vlen të përmendim çështjet Ramadhi kundër RSH dhe Driza kundër RSH të vitit 2008, konsideruar si vendime “pilot”, për të kuptuar rëndësinë, ndjeshmërinë dhe pasojat që sjell shkelja e së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm në kuptim të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

**27.6** Në vendimin e tij nr. 21/2019 datë 13.09.2019 Kolegji ka mbajtur qëndrim se: *“Për sa i përket raportit midis zbatimit të standardeve të gjykimit, të miratuara me vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010, të KLD-së, dhe zbatimit të përcaktimeve ligjore përkatëse, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se përparësi ka zbatimi i ligjit organik, në bazë të të cilit ushtron funksionin magjistrati. Subjekt rivlerësimi, në rastin konkret, rezulton të jetë gjyqtari i një gjykate administrative të shkallës së parë, dhe i zbatueshëm për këtë subjekt rivlerësimi është ligji organik nr. 49/2019.*



*Ligji organik nr. 49/2012, në nenin 3, si parim të përgjithshëm sanksionon gjykimin brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, por pa sanksionuar afat maksimal për gjykimin e çështjeve. Nga ana tjetër, ligji nr. 49/2012, përcakton afate për veprimet përgatitore (neni 25), seancën gjyqësore (neni 27), por nuk përfshihet mundësinë e zgjatjes së këtyre afateve, veçanërisht kur ato kanë qenë për shkaqe të përligjura. Trupi gjyqësor nuk ka konstatuar se zgjatja e afateve ka qenë për faj apo neglizhencë të subjektit të rivlerësimit, por ka ndodhur për shkaqe të përligjura, sikurse pamundësia objektive e subjektit të rivlerësimit, kryesisht për shkak të zënies së të gjithë kohës fizike me procese gjyqësore, që e kanë çuar atë në pamundësi fizike kohore”.*

**27.7** Si rrjedhojë të sa më sipër subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi të kohës fizike për të kryer çështjet brenda afateve të parashikuara në ligj. Një ngarkesë e tejshtuar me çështje ka pamundësuar realizimin e gjykimeve brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me ligj për përfundimin e gjykimeve administrative. Statistikat e sjella nga subjekti i rivlerësimit për çështjet e gjykuara prej saj në trupë gjyqësore, në vit, që prej krijimit të gjykatave administrative flasin qartë për një ngarkesë përtej limiteve të pranueshme njerëzore. Në kuptim të neneve 40-44 të ligjit nr.84/2016 subjekti i rivlerësimit ka qenë efiçente dhe efektive në një masë të pranueshme, me cilësi të pranueshme në punë në respektim të një gjykimi të drejtë dhe të drejtave të palëve në gjykim. Sa më sipër shkak i ankimit i Komisionerit Publik nuk gjendet i bazuar.

**27.8** Në vlerësim të përgjithshëm të aftësive profesionale, vlen që këto mangësi të analizohen në raport me të gjitha çështjet e tjera të analizuar prej Komisionit, edhe në kuadër të verifikimit të denoncimeve, e duke pasur në konsideratë edhe raportin e hartuar për çështjet e përzgjedhura me short e të dorëzuara prej vetë subjektit, ngarkesën e saj të punës, vitet e gjata në karrierë, peshën e këtyre mangësive në zgjidhjet e çështjeve konkrete dhe pasojat e ardhura, Kolegji çmon se gjen vend të zbatohet standardi i përdorur nga Gjykata Kushtetuese në interpretimin e saj në paragrafin 54 të vendimit nr. 2/2017, sipas të cilit: *“Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit të opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ”.* Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias). Në këndvështrim të këtij qëndrimi, Kolegji çmon se mangësitë e konstatuara si më lart nuk janë të një niveli të tillë që të konsiderohen serioze dhe as të përsëritura në mënyrë të vazhdueshme, që të përfaqësojnë defekte të rëndësishme për njohuritë profesionale të subjektit të rivlerësimit për t'i kualifikuar sipas nenit 61, pika 4 e ligjit 84/2016.

**28.** Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes së gjykuar në seancë publike, pasi dëgjoi edhe konkluzionet përfundimtare të Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit, vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë dhe vlerësimit të aftësisë profesionale, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përbërë nga aktet e përcjella

në Kolegj nga Komisioni, dhe parashtrimet e depozituara nga palët gjatë seancave publike, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionet e mëposhtme.

*Për vlerësimin e kriterit të pasurisë*

- I. Lidhur me pasurinë “godinë banimi 3-katëshe”, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, trupi gjykues pasi vlerësoi aktet e administruara gjatë hetimit administrativ si edhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, arriti në konkluzione të ndryshme nga Komisioni për sa i përket kohës së ndërtimit të godinës, kostot së ndërtimit të saj ndër vite, si dhe të ardhurave të ligjshme të bashkëpronarëve për financimin e kësaj pasurie, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, për një diferencë negative në shumën 7.278.526 lekë, si rrjedhojë ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
  - II. Lidhur me pasuritë “truall me sipërfaqe 437.6 m<sup>2</sup>”, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}” Tiranë dhe “njësi me sipërfaqe 25.7 m<sup>2</sup>”, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, për shkak të mungesës së deklaramit të gjendjes *cash* në vitin 2009, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie për një diferencë negative në vlerën 1.120.450 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
  - III. Lidhur me pasurinë “automjet Mercedes Benz” me targë {\*\*\*}, për shkak të mungesës së deklaramit të gjendjes *cash* për vitin 2008, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie për një diferencë negative në vlerën 484.400 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
  - IV. Lidhur me pasurinë “automjet Peugeot” me targë {\*\*\*}, nga analiza financiare e kryer për këtë vit, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie për një diferencë negative në vlerën 582.072 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
29. Në përfundim Kolegji, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në përputhje me nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës si dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë së saj dhe të personave të lidhur me të dhe për pasojë vendimi i Komisionit nr. 273, datë 10.07.2020 duhet ndryshuar pasi nuk gjendet i drejtë e i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 273, datë 10.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 23.11.2021, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Ne, gjyqtaret Ina Rama dhe Albana Shtylla, kemi votuar pro qëndrimit të mbajtur në vendimin e trupit gjykues për sa i përket pjesës më të madhe të argumenteve të arsyetuara në vendim dhe që legjitimojnë ndryshimin e vendimit nr. 92, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, duke mbajtur qëndrimin se, si bazë ligjore për shkarkimin e saj nga detyra, duhej të përdorej neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), për të gjitha arsyet e renditura e të arsyetuara në vendim, me përjashtim të votës “kundër”, lidhur me qëndrimin e mbajtur në vendim, se subjekti gjendet edhe në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasurinë tokë truall/parcelë ndërtimore me sipërfaqe 437,6 m<sup>2</sup>, nën ndërtesën e ndërtuar prej saj, të blerë në vitin 2010 nëpërmjet procedurave të legalizimit, dhe njësi shërbimi me sipërfaqe 25,7 m<sup>2</sup>, e blerë në vitin 2012.
2. Ky qëndrim nuk afekton vendimmarrjen e Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), por lidhet me një analizë të ndryshme të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit për sa i përket burimit të krijimit të depozitës në emër të personit të lidhur, me nr. {\*\*\*}, në Bankën Procredit. Mbi vlerësimin e burimit të krijimit të kësaj depozite, është ndërtuar analiza financiare që kontrollon mundësinë e subjektit për të financuar blerjen e dy pasurive të mësipërme. Likuiditeti i deklaruar në këtë depozitë është përdorur, pjesërisht, si burim financimi për blerjen e dy pasurive të përshkruara më lart. Shumica në vendim ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka pasur të ardhura për të justifikuar kreditimin e llogarisë në Bankën Procredit, për pasojë nuk ka konsideruar si të ardhura në analizë një pjesë të vlerës së ka qenë depozituar në të, duke konkluduar se subjekti ka qenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive.
3. Pakica, duke bërë një vlerësim të detajuar rrethanave të faktit në rastin konkret dhe deklarimeve të subjektit, ka arritur në një qëndrim të ndryshëm, duke pranuar si të besueshëm shpjegimin e subjektit lidhur me këtë situatë, shpjegim i cili mbështetet edhe nga deklaratimet që ai ka bërë në deklaratën periodike të interesave e pasurisë të vitit 2010.
4. Nga aktet në fashikull, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka hapur në shkurt të vitit 2008, një depozitë në Bankën Tirana, e cila është kredituar prej tij në mënyrë të vazhdueshme. Në datën 11.02.2009, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka tërhequr prej kësaj depozite në *cash* shumën prej 1.281.000 lekësh. Nuk rezulton të ketë një konkluzion se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kësaj shume. Nuk ka deklarim të subjektit në deklaratën periodike të vitit 2009, lidhur me këtë veprim të kryer prej tij.
5. Sipas *statement*-it bankar, rezulton se në datën 27.01.2010, është hapur prej bashkëshortit të subjektit depozita në Bankën Procredit, në të cilën është depozituar shuma prej 1.000.000 lekësh. Lidhur me këtë moment, subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2010, edhe krijimin e kësaj depozite, edhe burimin e krijimit të saj, duke përcaktuar: *Depozitë në emër të bashkëshortit në Bankën Procredit, në datën 27.01.2010, u mbyll depozita në Bankën Tirana dhe u hap këtu.*
6. Në vlerësimin tonë si gjyqtare, shuma prej 1.000.000 lekësh, e depozituar në depozitën e hapur në Bankën Procredit, duhet të konsiderohet se e ka burimin nga shuma e tërhequr në Bankën Tirana, më 11.02.2009, prej 1.281.000 lekësh.

7. Duke konfirmuar detyrimin e subjektit që, në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 9049/20103, të deklaronte gjendjen *cash* në banesë të kësaj shume, për sa kohë që ajo ishte tërhequr nga banka dhe, sipas shpjegimit të tij, zotërohej në banesë, ne e shohim këtë mosdeklarim si një pasaktësi të deklaratës periodike të vitit 2009, për shkak të faktit se depozitimi i shumës prej 1.000.000 lekësh ka ndodhur në datën 27.01.2010, pra vetëm një muaj pas momentit të cilin subjektet kanë detyrimin ta konsiderojnë për gjendjen e pasurive të tyre dhe se kjo kohë qëndron kronologjikisht para momentit të plotësimit të deklaratës periodike të pasurisë, e cila rezulton të jetë plotësuar në datën 18.03.2010.
8. Sipas kësaj kronologjie ngjarjesh, në momentin e plotësimit të deklaratës së vitit 2009, subjekti nuk posedonte më shumë prej 1.000.000 lekësh në gjendjen *cash*, duke qenë se ato ishin depozituar në Bankën Procredit në datën 27.01.2010, duke i dhënë sens pasaktësisë së deklarimit për këtë vit.
9. Ndërsa rezulton se subjekti në deklaratën e vitit pasardhës, në vitin 2010, ka deklaruar krijimin e kësaj pasurie duke identifikuar në mënyrë të posaçme burimin e krijimit të saj, si likuiditetin e përftuar nga depozita e mbyllur në vitin paraardhës.
10. Në kushtet e situatës faktike të përshkruar më lart, krijuam bindjen se mosdeklarimi i gjendjes *cash*, sipas detyrimit ligjor, vetëm për këtë shumë, në vitin 2009, duhej të konsiderohej si një pasaktësi e subjektit dhe se deklarimi i tij në vitin 2010 duhej të konsiderohej si me vlerë provuese në raport me burimin e krijimit të kësaj pasurie.
11. Në analizë të këtyre rrethanave, të para në raport me vlerën provuese të deklaratave periodike, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si edhe të drejtën e gjykatës për të çmuar e vlerësuar provat e administruara sipas një analize harmonike në raport me njëra-tjetrën, konform parashikimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, arritëm në konkluzionin se kjo shumë prej 1.000.000 lekësh, e përdorur për financimin e pasurisë së llojit truall e njësi, të përshkruar më lart, e ka burimin nga shuma prej 1.281.000 lekësh, që ishte tërhequr prej depozitës në Bankën Tirana e, për pasojë, duhej të konsiderohej si e krijuar me burime të ligjshme në analizën financiare që u krye për pasuritë më lart.

**GJYQTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Ne, gjyqtaret Natasha Mulaj dhe Rezarta Schuetz, në cilësinë e anëtareve të trupit gjykues, kemi votuar pro vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja [(JR) nr. 43, datë 30.09.2020], për të ndryshuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) me nr. 273, datë 10.07.2020 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, por nuk jemi dakord me shumicën e trupit gjykues sa i takon vlerësimit të aftësive profesionale në këtë çështje. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është kryer edhe mbi bazën e disa denoncimeve në ngarkim të subjektit, për të cilat Komisioneri Publik ka ushtruar ankim. Më poshtë, një përmbledhje e fakteve dhe vlerësimi ynë.
2. Denoncuesi i parë ngre tri pretendime që lidhen me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, e konkretisht, për vendimmarrje prej saj në lidhje me tre persona juridikë/palë ndërgjyqëse: (i) {\*\*\*} ShA; (ii) {\*\*\*} ShPK; dhe (iii) {\*\*\*}.
3. Sipas denoncuesit, sa u përket çështjeve me palë ndërgjyqëse {\*\*\*} ShA, subjekti i rivlerësimit ka marrë dy (2) vendime në cilësinë e relatores<sup>13</sup>, respektivisht më datë 29.09.2016 [vendimi me nr. {\*\*\*}] dhe më 18.02.2016 [me nr. vendimi {\*\*\*}]. Në çështjen e parë, pala tjetër ndërgjyqëse ka qenë Bashkia {\*\*\*}, në të dytën Bashkia e {\*\*\*}. Këto dy vendime rezultojnë të jenë marrë ndërkohë që subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, ishte aksionere e shoqërisë "{\*\*\*}" ShA, ku zotëronte 50 aksione<sup>14</sup>. Kjo gjendje fakti rezulton të ketë ndryshuar më pas – me aplikimin e datës 11.09.2017 është larguar, duke ia kaluar këto të drejta një personit të lidhur.
4. Megjithëse ka konstatuar shkelje që lidhen me etikën e magjistratit, kryer nga subjekti i rivlerësimit, mbi bazën e nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vendosur që dy vendimet në fjalë t'i kalojnë për inspektim shkeljesh të mundshme organit kompetent. Nga ana tjetër, sipas Komisionerit Publik, subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit dhe duhet të kishte hequr dorë sipas nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile.
5. Shumica e trupit gjykues vlerësoi që, ndonëse subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e konfliktit të interesit, shkelja nuk ka qenë në një nivel të tillë që mund të kualifikonte rastin sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke konsideruar edhe parashikimet në Komentarin e Bangalores dhe nën dritën e faktit që shoqëria "{\*\*\*}" ShA nuk ka rezultuar gjyqfituese.
6. Ne, gjyqtaret e pakicës, nuk jemi dakord me këtë vlerësim të shumicës pasi konstatojmë që ligji shqiptar nuk kushtëzon ekzistencën e konfliktit të interesit bazuar në një prag minimal [*interes de minimis*]. Ndërsa Parimet e Bangalores dhe komentari përkatës kanë një vlerë të jashtëzakonshme

<sup>13</sup> Shih parashtrimet e Komisionerit Publik në bisedimet përfundimtare, poshtëshënimi nr. 45.

<sup>14</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., përcjellë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit më datë 28.01.2019 nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Me aplikimin e sipërcituar, aksioner rezultoi i biri i subjektit të rivlerësimit [D. D. G.], sipas Ekstraktit të Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve, datë 31.08.2017.

reference, vlerësimi i trupit gjykues do të duhej të bazohej në ligjin e zbatueshëm në fuqi në Republikën e Shqipërisë, e konkretisht, neni 72, paragrafi VI dhe dispozitat e ligjit nr. 9367/2005 “Për ndalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, për sa i përket konfliktit të interesit në dukje apo atij rast pas rasti, parashikuar në nenin 3. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, përkundër rëndësisë që ka vendimmarrja e paanshme, transparente, në interesin më të mirë të besimit të publikut ndaj institucioneve publike, parandalimi i konfliktit të interesit nga zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta, qoftë edhe në dukje<sup>15</sup>, do të ishte në përputhje me rregullat e detyrueshme që përcakton kuadri ligjor. Në rrethanat konkrete, faktorë të tillë, si numri i ulët i aksioneve apo mënyra e zgjidhjes së çështjes nga gjykata, mbi të cilët është bazuar shumica, do të duhej të ishin marrë në konsideratë në vlerësim të përgjithshëm nga trupi gjykues i Kolegjit dhe, parë së bashku me problemet e konstatuara në mënyrë të përsëritur, shtjelluar më poshtë, do të duhej të ishin vlerësuar për atë që përfaqësojnë: një vazhdë veprimesh të subjektit që duhej analizuar në drejtim të zbatimit të dispozitave ligjore të detyrueshme prej tij, në kuadër të etikës ose të perceptimit të publikut.

7. Për sa u përket çështjeve me palë ndërgjyqëse {\*\*\*} ShPK, denoncuesi parashtron se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim në dy shkallë të ndryshme në të njëjtën çështje gjyqësore, me palë dhe objekt të njëjtë, e konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit me vendimet me nr. {\*\*\*}, datë 14.09.2009 dhe nr. {\*\*\*}, datë 02.04.2014. Vendimi i fundit, në vijim të rekursit të ushtruar, është prishur nga Gjykata e Lartë për shkak se pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit si anëtar i trupit gjykues në të dyja shkallët, në të njëjtën çështje, cenon të drejtat për proces të rregullt sipas nenit 6 të KEDNj-së dhe nenit 42 të Kushtetutës.
8. Në përfundim të hetimit për këtë çështje, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka konstatuar se mungojnë shkelje që e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar detyrën, dhe ia ka përcjellë edhe këtë vendim “organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme”, në interpretim të nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik vlerësoi që subjekti i rivlerësimit, në këtë situatë, shfaq mangësi të theksuara sipas kuptimit të neneve 75, pika 4 dhe 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 lidhur me detyrimin kushtetues për gjykimin e paanshëm nga gjykatat, duke mos respektuar parimet kushtetuese për një proces të rregullt, parashikuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës. Po ashtu, Komisioneri thekson që transferimi i kësaj çështjeje organit inspektues, është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
9. Shumica e trupit gjykues të Kolegjit ka vlerësuar të mbështesë vlerësimin e saj mbi referencën e Gjykatës Administrative të Apelit për mungesë të një shënimi konkret për ekzistencën bashkëlidhur dosjeve të përcjella në atë gjykatë, si provë që dëshmon bindshëm faktin që subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur në dispozicion dosjen [që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 14.09.2009], për të kuptuar që ka gjykuar një padi me të njëjtat palë.

---

<sup>15</sup> Shih nenet 1 dhe 3, pika 3, germa “b” e ligjit nr. 9367/2005.

10. Nuk jemi dakord me këtë arsyetim të shumicës, që rezulton të jetë bazuar kryesisht mbi prapësimet e subjektit, për disa arsye. Së pari, sepse vërejmë që ky pretendim i subjektit, për padijeni të gjendjes faktike për shkak të mungesës së fashikullit – referuar në vitin 2020<sup>16</sup> nga gjykata ku vetë subjekti shërbente si gjyqtar, dhe ngarkesës në punë dhe, për pasojë, mungesës së dijenisë objektive nga subjekti, bie ndesh me sa ka konstatuar Gjykata e Lartë, e cila e ka bazuar konkluzionin e saj mbi ekzistencën në fashikull të akteve në fjalë, të cilat tregonin pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit. Me fjalë të tjera, argumenti mbi mosplotësinë e fashikullit që referohet nga Gjykata e Apelit Administrativ dhe subjekti, i pranuar nga shumica, bie ndesh me sa ka konstatuar Gjykata e Lartë dhe paditësi rekursues në vitin 2014. Nga vendimi i Gjykatës së Lartë, rezulton që fashikulli i përcjellë Gjykatës së Lartë nga Gjykata e Apelit Administrativ, pas rekursit të ushtruar nga paditësi “{\*\*\*}” ShPK, ka pasur në përmbajtje aktet dhe fashikujt e krijuar gjatë gjykimit në shkallën e parë. Pikërisht mbi bazën e këtyre akteve, Gjykata e Lartë ka marrë vendim në vitin 2016 [nr. {\*\*\*}, datë 06.07.2016<sup>17</sup>], të prishë vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të dërgojë çështjen për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues [nr. {\*\*\*}, datë 02.04.2014], duke specifikuar shprehimisht se:

*[...] nga studimi i dosjes, ka rezultuar se një nga anëtarët e kolegjit pranë Gjykatës Administrative të Apelit (gjyqtarja Alkelina Gazidede), ka marrë pjesë në vendimmarrjen objekt rekursi, në një kohë që po kjo gjyqtare, për të njëjtën çështje, me palë dhe objekt të njëjtë, ka dhënë vendim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, duke pranuar pjesërisht padinë e paditësit [...].*

11. Së dyti, ndryshe nga shumica, vërejmë që analiza e kryer nga ne gjyqtaret e pakicës si më sipër, do të duhet të ishte pjesë e një vlerësimi gjithëpërfshirës nga Kolegji gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit, që do të merrte në konsideratë edhe sa është konstatuar në lidhje me veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me vendimet që kishin për palë ndërgjyqëse {\*\*\*} ShA, të shtjelluara gjerësisht më sipër, dhe çështjet që vijojnë më tej në këtë analizë. Në këtë analizë, rezulton po ashtu edhe që vendimmarrja e Komisionit për transferimin e kësaj çështjeje organit inspektues, është haptazi në kundërshtim me përcaktimin e nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon që transferimi i një çështjeje për inspektim nga Komisioni, kryhet vetëm si pasojë e (i) evidentimit të shkaqeve që përbëjnë shkelje disiplinore [nga Komisioni], ose (ii) evidentimit [nga Komisioni] të shkaqeve që duheshin marrë në konsideratë gjatë vlerësimit periodik të subjektit. Në rastin konkret, siç është shtjelluar më sipër, Komisioni *nuk* ka konstatuar shkelje që e bëjnë magjistraten të papërshtatshme, përkundrazi, dhe as shkaqe që duheshin marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të saj periodik. Megjithatë, Komisioni, në tejkallim të hapur të gjuhës së ligjit, ia ka transferuar çështjen organit përkatës<sup>18</sup>. Në dritën e këtyre fakteve, vlerësojmë se pretendimi i Komisionerit Publik është i bazuar dhe duhet të ishte pranuar në tërësinë e tij, ndërsa

<sup>16</sup> Në përgjigjen e datës 30.01.2020, Gjykata Administrative e Apelit referon se në inventarin e dosjes, përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk rezulton që fashikulli i dosjes me nr. {\*\*\*} vendimi, datë 14.09.2009 “[...] të jetë përcjellë me dosjen gjyqësore që ka ardhur në Gjykatën Administrative të Apelit, bazuar në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.02.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

<sup>17</sup> Me numër dhe datë regjistrimi në Gjykatën e Lartë {\*\*\*}.

<sup>18</sup> Pjesa e fundit [pa numër] e paragrafit 38.3, faqe 62 e vendimit të Komisionit në:  
<https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/08/Vendim-Alkelina-Gazidedja.pdf>.



vlerësimi i rrethanave të sjella në dijëni të Kolegjit, duhet të ishte bërë pjesë integrale e vlerësimit të kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

12. Pretendimi tjetër i denoncuesit [shih edhe paragrafin 2] lidhet me shqyrtimin e çështjes administrative me palë ndërgjyqëse {\*\*\*} dhe një individ, z. P. D., dhe me objekt të njëjtë nga subjekti i rivlerësimit në dy shkallë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në periudhën mars, prill dhe maj 2010 dhe në Gjykatën e Apelit Administrativ në datën 04.02.2014.
13. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në konkluzion, ka konstatuar se nuk gjendej përpara shkeljeve që e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin, por gjithsesi ia ka përcjellë vendimin organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme. Sipas Komisionit, subjekti nuk rezulton të ketë dhënë këshilla, apo shfaqur mendime për çështjen në gjykim apo të ketë marrë pjesë në gjykimin në themel. Edhe në këtë rast, Komisioni i është referuar nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016<sup>19</sup>.
14. Komisioneri Publik, nga ana tjetër, në lidhje me sa argumentohet në këtë pjesë të denoncimit, sjell në vëmendje vendimin e Gjykatës së Lartë<sup>20</sup>, i cili ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ për shkak se qenia anëtare e trupës gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, në gjykimin në shkallë të parë “nuk ka qenë e papërfillshme” dhe, për rrjedhojë, “dyshimi i palës së paditur është i bazuar nga ana objektive<sup>21</sup>”. Po ashtu, Komisioneri Publik argumentoi që në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi të theksuar sipas nenit 75, pika 4 dhe 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, lidhur me detyrimin kushtetues për gjykatë të paanshme, duke marrë pjesë në dy shkallë gjykimi, duke mos respektuar detyrimet për procesin e rregullt ligjor. Edhe për këtë çështje, Komisioneri thekson se transferimi organit inspektues nga Komisioni, përbën një interpretim të gabuar të nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Së fundmi, çështjet e transferuara nga Komisioni për inspektim disiplinor kanë passjellë përjashtimin e zbatimit të nenit 61, pika 5 – konstatimin për cenim të besimit të publikut – lidhur me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 – vlerësimi tërësor – të cilat duhen analizuar së pari si lëndë vlerësimi, për qëllim të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit që duhet të kryhet nga organet e rivlerësimit.
15. Si rrjedhojë, vlerësimi i shumicës se nuk rezulton të ketë ekzistuar asnjë nga shkaqet e papajtueshmërisë së parashikuar nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, po ashtu është interpretim i gabuar i ligjit. Në shqyrtimin e rekursit, bazuar ndër të tjera në papajtueshmërinë e subjektit të rivlerësimit në shqyrtimin e çështjes në dy shkallë të juridiksionit gjyqësor, Gjykata e Lartë ka listuar veprimet e kryera nga subjekti në shkallën e parë, përfshirë dispozitat e neneve 158/a dhe 158/b mbi veprimet e kryera nga gjyqtari gjatë seancës përgatitore. Nga ana tjetër, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e sa është shtjelluar në arsyetimin e hollësishëm që ka kryer Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit mbi pjesëmarrjen e saj në vendimmarrje në

<sup>19</sup> Pjesa e fundit [pa numër] e paragrafit 84.3, faqe 63 e vendimit të Komisionit në linkun më sipër.

<sup>20</sup> Shih vendimin e Gjykatës së Lartë, datë 07.12.2016, me nr. {\*\*\*}.

<sup>21</sup> Paragrafi 24, vendimi i Gjykatës së Lartë, datë 07.12.2016, me numër {\*\*\*}.

shkallë të parë dhe veprimet konkrete të kryera prej saj. Përpos këtij argumenti, siç është shtjelluar edhe gjetkë në këtë mendim tonin, përfshirja e subjektit të rivlerësimit në dy shkallë gjykimi në të njëjtën çështje, ka rezultuar të ketë ndodhur të paktën dy herë në morinë e çështjeve të analizuara në kuadër të procesit të rivlerësimit. Konkluzioni se nuk ka qenë e papërfillshme përfshirja e subjektit të rivlerësimit në gjykimin në shkallë të parë, duhet të ishte marrë në konsideratë nga shumica dhe, në konkluzion, të vlerësohej krahas mangësive të tjera të parashtruara nga Komisioneri Publik dhe analizuar në hetimin administrativ e gjatë procesit gjyqësor në Kolegj.

16. Të tria problemet e analizuara më sipër tregojnë një mungesë ndjeshmërie nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, për mënyrën se si prania e saj do të mund të perceptohej nga publiku. Për këto arsye, në kushtet kur është e vështirë të provohet përtej dyshimit prezumimi i paanësisë subjektive të gjyqtarit, përgjegjësitë për të ofruar paanësi objektive përbëjnë një garanci të mëtejshme<sup>22</sup>. Këtë përgjegjësi, subjekti mund ta ushtronte vetëm duke kërkuar dorëheqjen nga trupat gjykues në fjalë, në konsideratë të besimit që gjykatat duhet të krijojnë në një shoqëri demokratike.
17. Në këtë kuadër dhe në vijim të arsyetimit tonë më sipër [shih paragrafin 11], vlerësojmë se duhet të ishte analizuar edhe pretendimi i Komisionerit që transferimi i çështjeve gjatë procesit të rivlerësimit nga Komisioni tek organi kompetent, pa konkluduar për shkaqe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore apo që duhen analizuar në vlerësimin periodik, mund të passjellë evitimin e analizimit të këtyre shkaqeve gjatë rivlerësimit. Ky pretendim i Komisionerit është i drejtë, pasi transferimi për inspektim nga Komisioni i çështjeve të sipërcituara, të cilat përmbajnë elemente që duheshin vlerësuar nën dritën e cenimit të besimit të publikut, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, bie ndesh me gjuhën dhe qëllimin e normave që rregullojnë procesin e rivlerësimit.
18. Aspekti tjetër në të cilin nuk jemi dakord me shumicën, lidhet me denoncimin nga një individ, analizuar nga Komisioni dhe parashtruar si shkak ankimi nga Komisioneri Publik<sup>23</sup>. Sipas argumenteve të parashtruara në denoncim e më tej në ankim, subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, ka marrë vendim në Gjykatën e Apelit Administrativ në vitin 2015<sup>24</sup>, mbi bazën e një vendimi të shfuqizuar nga një gjykatë apeli në vitin 1999, që më pas është pushuar nga gjykata e shkallës së parë po në vitin 1999, pas rigjykimit. Komisioni ka konstatuar që, pavarësisht shpjegimeve të subjektit, përgjegjësia kryesore binte mbi relatorin dhe jo mbi atë si anëtar të trupit gjykues, por subjekti kishte të drejtë të shihte provat dhe të njihte dosjen në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues. Në konkluzion, pavarësisht problemeve të konstatuara, Komisioni konkludoi që veprimet e subjektit nuk përbëjnë shkak për shkarkimin e tij.

---

<sup>22</sup> Pullar kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 32 në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57995>.

<sup>23</sup> Paragrafi 37, faqe 29 e ankimit të Komisionerit Publik.

<sup>24</sup> Denoncimi i z. Q. V., përcjellë më 24.04.2019, ku parashtrohet që vendimi i Gjykatës së Apelit Administrativ i datës 19.11.2015 ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë të datës 01.07.2013, me një arsyetim që rrëzoi padinë mbi bazën e një vendimi të Gjykatës së Faktit Vlorë [të datës 09.12.1998] që është prishur e kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit Vlorë më 26.04.1999.

Nga ana tjetër, Komisioneri Publik pretendoi *se shkelja “është e karakterit procedural”* dhe duhet marrë parasysh në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

19. Shumica e trupit gjykues ka vlerësuar në të njëjtën linjë me Komisionin, duke konstatuar përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit, të cilat nuk mund të shoqërohen me masë disiplinore për subjektin për shkak të cilësisë së tij vetëm si anëtar në trupin gjykues. Në vlerësimin tonë, si edhe më sipër, theksojmë se ky konstatim duhet parë së bashku me gjithë sa është përshkruar më sipër dhe do të duhet të ishte pjese integrale e vlerësimit tërësor të pyetjes nëse subjekti me veprimet e tij ka treguar mangësi të natyrës profesionale dhe nëse ato ishin të tilla që së bashku të tregonin një vazhdë/model sjelljeje që cenon besimin e publikut. Mënyra e vlerësimit që ka ndjekur shumica e trupit gjykues edhe në analizë të këtyre pretendimeve, fragmentarizon ndodhitë, duke i analizuar vetëm veçmas dhe jo si pjesë të një vlerësimi tërësor, të diktuar nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016<sup>25</sup>. Për këto arsye, vlerësojmë që pretendimi i Komisionerit Publik për sa pretendohet në denoncim, është i drejtë dhe duhej të ishte pranuar.
20. Së fundmi, nuk ishim dakord edhe me vlerësimin e kryer nga shumica në analizë të pretendimeve të Komisionerit që bazohen mbi një denoncim individual, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, ka marrë vendim mbi bazën e një vendimi të Gjykatës së Lartë që ishte shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese<sup>26</sup>. Komisioni nuk duket të ketë nxjerrë një konkluzion konkret për këtë denoncim, përveçse të sjellë në vëmendje cilësinë e subjektit të rivlerësimit si anëtar – përkundër përgjegjësi si kryesues/relator – dhe ngarkesën e madhe të çështjeve dhe në një përllogaritje fundore ka theksuar se ka gjetur probleme vetëm në dy nga 27 denoncime, të cilat u atribuohen relatorëve të çështjeve<sup>27</sup> përkatëse dhe jo vetë subjektit. Po ashtu, Komisioni ka konkluduar se nuk konstatohen gabime të vazhdueshme dhe as shkelje serioze e, për pasojë, nuk mund të klasifikohen si mangësi profesionale.
21. Komisioneri Publik pretendon se shkelja e konstatuar është e karakterit procedural dhe duhet marrë parasysh në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, Komisioneri Publik konstaton që mangësitë dhe problematikat e konstatuara në mënyrë të përsëritur edhe nga Komisioni, në rastet e mësipërme, bazuar në një vlerësim objektiv mbi kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 96/2016, si dhe në një vlerësim tërësor bazuar në nenin 4, pika 2, duhet të çojnë në zbatimin e nenit 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.
22. Shumica e trupit gjykues e vlerësoi edhe këtë problem në të njëjtën linjë më atë të ndjekur nga Komisioni, sikurse edhe faktet e denoncuara nga z. V., parashtruar në paragrafët 18 dhe 19. Pa

---

<sup>25</sup> “[...] Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave [...]”.

<sup>26</sup> Denoncim i z. P. P., përcjellë në Komision më datë 08.04.2019, ku parashtrohet që vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit me nr. {\*\*\*}, datë 14.02.2018, ka rrëzuar padinë mbi bazën e vendimit të Gjykatës së Lartë nr. {\*\*\*}/2003, i cili është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. {\*\*\*}/2013.

<sup>27</sup> Paragrafi 80.7 i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në:  
<https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/08/Vendim-Alkelina-Gazidedja.pdf>.

dashur të përsëritim argumentet e parashtruara në paragrafin 20, theksojmë që edhe faktet e pretenduara në lidhje me këtë procedim dëshmojnë problematika të cilat do të duhet të ishin parë në mënyrë integrale dhe të analizoheshin në drejtim të nenit 61, pika 5, pasi kjo është edhe gjuha e përcaktimeve ligjore të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

23. Së fundmi, vlerësimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit për subjektin, sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale, duhej të kishte mbajtur në vëmendje faktin që në çështjet e sipërcituara, analiza kapërcen pragun e një qasjeje të veçuar duke krijuar një mënyrë veprimi të vazhdueshëm. Në këto kushte, në vlerësimin tonë, kishte vend që këto ngjarje të ishin vlerësuar nën dritën e mangësive profesionale të shtjelluara në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, mbështetur në opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2016)036. Në konkluzion, konstatojmë se pretendimet e Komisionerit Publik janë të drejta dhe duhet të ishin pranuar nga shumica e trupit gjykues. Po ashtu, votuam që vendimi për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, duhej të ishte bazuar edhe mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, përveç atij të pasurisë.

**GJYQTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*